RAPORT
2006

**KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT**
**KRYETARI**

Nr. 72/1 Prot. Tiranë më 16 . 4 2007

Lënda: Mbi dorëzimin e raportit të KKRT për vitin 2006

**KUVENDIT TE SHQIPERISE**

**Kryetares, Zonjës Jozefina TOPALLI**

E nderuara zonja Kryetare

Ju lutem, më lejoni paraprakisht t'Ju falenderoj për ndihmën e deritanishme që i keni dhënë Keshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, ndihmë të cilën e vlerësojmë shumë dhe shpresojmë ta kemi edhe në të ardhmen.

Bashkëlidhur po Ju sjellim Raportin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2006, brenda afatit të përcaktuar nga Ju, në shkresën me nr. 139 prot., datë 16.01.2007.

**KRYETARI**

**Ledi BIANKU**

# *PERMBAJTJA E RAPORTIT TE KKRT PER VITIN 2006*


*I. HYRJE*

*II. REFORMAT NË FUSHËN AUDIOVIZUALE*

A. *Arsyet dhe drejtimet - standardet europiane në fushën e medias elektronike*

B. *Reformat e ndërmarra në fushën e medias*
- *i. Rivendosja dhe respektimi i ligjshmërisë në tregun mediatik*
- *ii. Reforma ligjore*
- *iii. Reforma administrative*

C. *Bashkëpunimi ndër-institucional*
- *i. Me Autoritetin e Konkurrencës*
- *ii. Me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë*
- *iii. Me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Entin Rregullator të Telekomunikacioneve*
- *iv. Bashkëpunimi me institucione të tjera*
- *v. Bashkëpunimi me mediat*
- *vi. Bashkëpunimi me shoqërinë civile*

D. *Bashkëpunimi Ndërkombëtar*

*III. SITUATA, PROBLEMET DHE PRIORITETET NË FUSHAT SPECIFIKE*

A. *REZULTATET E ARRITURA NË FUSHËN E LICENCIMIT*
- *i. Dhënia e Licencave*
- *ii. Rinovimi i Licencave*
- *iii. Mosrinovimi i licencave*
- *iv. Licencimi i subjektit "Ora" Sh.P.K*

B. *OPERATORET PRIVATE RADIO E TELEVIZIVË*
- *i. Operatoret Kombëtarë*
- *ii. Operatorët Vendorë/Operatorët e rinj vendorë*
- *iii. Mbulimi i realizuar nga operatorët vendorë radio e televizivë*
- *iv. Operatorët që kanë instaluar stacione jashtë zonës së tyre të licencimit*
- *v. operatorët satelitorë*

*C. PLANI I FREKUENCAVE*

*i. Administrimi i frekuencave në Shqipëri*

*ii. Plani i Frekuencave dhe RRC-06*

*iii. Plani shqiptar i transmetimeve numerike tokësore*

*D. PROGRAMACIONI*

*i. Të drejtat e transmetimit në RTV dhe të drejtat e autorit*

*ii. Programet Informative*

*iii. Etika në media*

*E. BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARE*

*i. Realizimi i të ardhurave*

*ii. Bilancet kontabël të operatorëve RTV*

*iii. Si paraqitet rezultati ekonomiko financiar i operatorëve radiotelevizivë*

*iv. Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit*

***IV. PËRFUNDIME***

*(Tabela ~~financiare)~~*

**RAPORTI VJETOR I KESHILLIT KOMBETAR të RADIOS DHE TELEVIZIONIT**
**(Veprimtaria gjatë vitit 2006)**

## I. *HYRJE*

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që, në emër të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, të raportoj sot përpara jush, për punën e kryer nga ky Këshill gjatë vitit 2006, për problemet dhe vështirësitë e hasura, për rezultatet e arritura si dhe për atë se çfarë duhet dhe mendohet të bëhet në të ardhmen.

Fillimisht do të doja të theksoja se liria e shprehjes, gur themeltar në konceptimin dhe funksionimin e shoqërive demokratike të mbështetura në respektimin e të drejtave të njeriut, ndër elementet e saj kryesorë ka lirinë e individit për të marrë informacion, lirinë për të dhënë informacion dhe lirinë e medias për të marrë dhe dhënë informacion. Kjo e fundit trajtohet gjithnjë si e drejtë më vete, për shkak të rolit të veçantë që luan media në një shoqëri demokratike. Liria e mediave mbetet një proces i përmbushjes së komponentëve të një natyre më të gjerë, që ka të beje drejtpërsëdrejti me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me funksionimin e një shteti të së drejtës dhe një shoqërie demokratike.

Pozicioni i "*privilegjuar*" i medias në një shtet demokratik garantohet për shkak se është pikërisht ajo, që e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm për njerëzit, më të kontrollueshëm dhe më transparent. Media ndikon që individët e angazhuar në të tre pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre si dhe në jetën dhe angazhimet e tjera shtetërore dhe private. Media është gjithashtu një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar sesi funksionarët e veshur me pushtet, ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndërmjet të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë si formë e qeverisjes. Garantimi kushtetues dhe ligjor i kësaj lirie përbëjnë bazën fillestare dhe përfundimtare të ushtrimit të kësaj lirie, në respektim të të drejtave të tjera të individit si dhe të parimeve themelore të shtetit demokratik.

Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pikërisht të drejtën për lirinë e shprehjes. Sipas këtij neni:

1. *Liria e shprehjes është e garantuar.*
2. *Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.*
3. *Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.*
4. *Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.*

Për implementimin e këtij neni kushtetues dhe në zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30/09/1998 " Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që në muajin Dhjetor 1999, është ngritur dhe funksionon si organ i pavarur Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, misioni i të cilit është rregullimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë radio-televizive në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjatë gjithë kësaj periudhe, që nga ngritja dhe funksionimi i kësaj strukture, është vënë re një progres i vazhdueshëm në rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në këtë fushë, në hartimin e akteve ligjore dhe nën-ligjore, në procesin e liçensimit, administrimit të frekuencave dhe teknologjive të reja, përpilimit të hartës së frekuencave si dhe në ecurinë e punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit dhe Planit të Frekuencave për Transmetimet Radio-Televizive.

Duhet të theksohet fakti që fusha e mediave elektronike ka pësuar dhe pëson në vazhdimësi zhvillime të qenësishme vitet e fundit në kuadrin e reformimit thelbësor që synon ndërtimin e një ekonomie të tregut konkurrues në këta

sektorë dhe aktualisht ndodhet në një fazë zhvillimi të veçantë, në një mjedis ekonomik të favorshëm.

Institucioni i KKRT-se në fushën e mediave elektronike po luan gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm në jetën ekonomike të vendit dhe pritet së afërmi një kontribut edhe më i madh, si rrjedhojë e zhvillimeve të rëndësishme teknologjike dhe ekonomike në fushën e transmetimeve televizive. Interesi publik për stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e fushës së mediave elektronike mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikave që ka pasur kjo fushë në të shkuarën, problematika të cilat ende nuk janë adresuar tërësisht.

Gjithsesi, pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve pozitive, zhvillimi dhe konsolidimi i veprimtarisë në këtë fushë është përballur me sfida dhe vështirësi të shumta të cilat janë prezent edhe sot. Këto vështirësi dhe problematika kanë qenë të lidhura kryesisht me boshllëqet në legjislacionin ekzistues, mos respektimin e konkurrencës së ndershme në tregun e mediave elektronike, problemet në mbrojtjen e të drejtës së autorit, piraterinë, zhvillimet e vrullshme në këtë fushë etj.

## *II. REFORMAT NË FUSHËN AUDIOVIZUALE*

### *A. Arsyet dhe drejtimet - standardet evropiane në fushën e medias elektronike*

Me nënshkrimin dhe ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, fusha e politikave audio-vizuale mbart një rëndësi të veçantë në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, edhe për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshje. Angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit synojnë, ndërmjet të tjerash, garantimin e konkurrencës në tregun e rrjeteve të komunikimit dhe shërbimeve në përputhje me rregullat e konkurrencës që zbatohen nga Komuniteti si dhe përafrimin e legjislacionit në këtë fushë me *acquis communautaires* dhe përputhjen me politikat dhe të drejtën e BE-së.

Sigurisht që realizimi i këtyre detyrimeve, do të kërkonte në radhë të parë ndërmarrjen e një reforme të plotë ligjore në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira europiane si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të KKRT-së, për të bërë të mundur ushtrimin e plotë të funksioneve dhe detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi si dhe të reformave që priten të bëhen në të ardhmen në këtë fushë.

Këto angazhime, të cilat janë pasqyruar edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (miratuar nga Qeveria Shqiptare

në Qershor 2006), shkojnë në të njëjtën linjë me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Europian në fushën e mediave elektronike, rekomandime që rrjedhin nga takimet e formateve të ndryshme, raportet vjetore të Komisionit Europian mbi situatën e përgjithshme në Shqipëri, Dokumentin e Partneritetit Europian (2005), dokumentet e Këshillit të Europës, në të cilat është theksuar shumë qartë nevoja e ndërmarrjes së një reforme të gjerë ligjore dhe institucionale në fushën e mediave, në përputhje me standardet dhe politikat e BE-së dhe më gjerë.

Në mbështetje të nevojës për kryerjen e këtyre reformave, do të ndaleshim në mënyrë të veçantë në Raportin e fundit të Komisionit Evropian "Mbi situatën në Shqipëri" ( Tetor 2006), ku është theksuar, ndërmjet të tjerash, shprehimisht se :

*Megjithatë, marrëveshja politike e Gushtit 2006, mund të çojë në ndryshime të mëtejshme në KKRT dhe KDRTSH dhe mbetet për tu pare zbatimi i sakte i rrugës se zgjedhur. KKRT ka nevoje për burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të realizuar detyrat e saj, veçanërisht shpërndarjen e frekuencave në përputhje me Planin e Frekuencave, parandalimin e zënies pirate të frekuencave, luftën për mbrojtjen e të drejtave të autorit, piraterinë dhe monitorimin e transmetuesve. Shqipëria ka nevoje që të miratoje ligje për të luftuar piraterinë në media si dhe të rregulloje transmetimet dixhitale në linjë me standardet e BE-se. Përqasja me Direktivën e Televizionit Pa kufij mbetet në fazën e hershme. Shqipëria duhet të siguroje që legjislacioni ekzistues në fushën e medias të zbatohet në përputhje me standardet e BE-se"*

Ky vizion, ka arsyetuar dhe drejtuar edhe reformat përkatëse, të vëna ndërkaq në lëvizje në lidhje me politikat audiovizuale në Shqipëri.

## B. *Reformat e ndërmarra në fushën e medias*

### i. *Rivendosja dhe respektimi i ligjshmërisë në tregun mediatik*

Një nga hapat dhe momentet më të rëndësishme të punës së KKRT, gjatë kësaj periudhe, ka qenë padyshim vendimi i marrë më datë 6/11/2006 "Mbi shfuqizimin e moratoriumit të vendosur nga KKRT e mëparshme në lidhje me pezullimin e dhënies se liçensave për zonën Tirane -Durrës të 30 majit 2003 (vendimi nr. 143) dhe për të gjithë pjesën tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë të 17 korrikut 2006 (vendimi nr. 501).

Themi më të rëndësishëm, pasi me këtë akt i dhamë fund një vendimi absurd në kundërshtim dhe në papajtueshme ri të plote me legjislacionit kombëtar dhe aktet ndërkombëtare në këtë fushe.

Për ato persona që nuk e kanë akoma të qarte situatën e krijuar, dhe veçanërisht për ato media elektronike dhe të shkruara që gjatë gjithë kësaj periudhe në mënyrë sa diletanteske nga pikëpamja e së drejtës audiovizuale, sa paragjykuese nga pikëpamja e së drejtës penale dhe publike aq edhe agresive nga pikëpamja etike, kanë përfolur institucionin e KKRT-se apo kanë ushtruar presione të ndryshme, vetëm për qëllime dhe interesa thellësisht personale, duke i ofruar opinionit publik një interpretim të paligjshëm të fakteve ose edhe shtrembërim të fakteve, por edhe për media të tjera që gëzojnë dhe shfrytëzojnë lirinë e medias në Shqipëri, do të donim ti informonim që:

Me Vendimin nr. 143 datë 30.05.2003, KKRT e mëparshme kishte vendosur të ndalej liçensimi i transmetuesve të rinj televizivë analogë tokësorë në brezin e UHF për mbulimin e rajonit të Tiranës nga mali i Dajtit (deri në Myzeqe). Ndërsa me vendimin nr. 501, datë 17.07.2006, KKRT kishte vendosur që deri në përfundim të planit analog, të pezullohej në të gjithë Shqipërinë dhënia në përdorim e frekuencave të reja, qoftë për liçensa të reja, qoftë për përmirësimin e mbulimit për operatorët e liçensuar.

Pas një analize të kujdesshme juridike, u arrit në konkluzionin se marrja e këtyre vendimeve ishte bërë në kundërshtim flagrant me nenet 17 dhe 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në kapërcim të kompetencave që parashikohen në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. KKRT në bazë të këtij ligji ka të drejtë të vendosë për dhënien ose mosdhënien e liçensave, po në *asnjë rrethanë e në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë të vendosë për bllokimin e dhënies së liçensave*. Një interpretim i tillë, absurd juridikisht, është produkt i një antifunksionalizmi institucional, plotësisht të papajtueshëm me parimet kushtetuese europiane.

Vendimet e sipërpërmendura të KKRT vinin, gjithashtu, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, të datës 24 nëntor 1993, në lidhje me çështjen "Informationsverein Lentia dhe të tjerë kundër Austrisë" *(kërkesat nr. 13914/88, 15041/89, 15717/89, 15779/89 & 17207/90)*. Në këtë çështje që përbën guidën e standardit të lirisë së shprehjes me mjete audiovizuale në Evropë, Gjykata e Strasburgut, jo vetëm që sugjeron që çdo situatë monopoli apo oligopoli që sjell bllokimi *a priori* i dhënies së liçensave vjen në kundërshtim me parimin e pluralizmit në media, por bën të qartë gjithashtu që çdo kufizim i të drejtës për të marrë liçensa mund të bëhet vetëm me ligj dhe mund të justifikohet vetëm nga pamundësitë teknike. Gjithashtu, vendimet e mësipërme të KKRT vijnë në kundërshtim edhe me Vendimin nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilës të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj. Në rastin konkret, *Kuvendi është i vetmi organ kompetent, që në mbështetje të Kushtetutës dhe vetëm nëpërmjet ligjit, mund të ngrijë*

*procesin e dhënies së licencave për operatorë radiotelevizivë.* Këtë ngrirje Kuvendi e ka bërë me ligjin nr. 8969, datë 07.11.2002 "Për disa masa në fushën e transmetimeve radiotelevizive", por vetëm për një afat kohor 5(pesë) mujor. Pas skadimit të këtij afati, në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe parimin kushtetues të subsidiaritetit, KKRT-të më 2003 dhe 2006 marrin dy vendime sa të kundraligjshme, aq të çuditshme por gjithsesi me vlera kazuistike - ngrirjen e dhënies së liçensave televizive mbi pjesë apo të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Vendimet e mësipërme jo vetëm që kanë shkelur të drejtën për lirinë e shprehjes, parimin e ligjshmërisë dhe kufirin e kompetencave që KKRT-së i jep ligji, por kanë cenuar në të njëjtën kohë edhe kompetencat e Kuvendit të Shqipërisë, i cili në bazë të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit nr. 8410 të sipërcituar, është i vetmi organ që, në situata përjashtimore, mund ta vendosë një gjë të tillë me ligj. Edhe në rast të një ligji për këtë qëllim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, masa i duhet njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, si një masë deroguese *en block* të së drejtës për tu pajisur me liçensë radio-televizive. Një njoftim i tillë nuk është bërë dhe kjo përbën edhe shkelje të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në bazë të neneve 10 dhe 15 të KEDNJ dhe nënkupton një nga shkeljet më të rënda ligjore që Republika e Shqipërisë iu ka bërë akteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në historinë e vet.

Për më tepër që, edhe në prani të këtyre vendimeve të miratuara vetë, KKRT e mëparshme kishin dhënë liçensa edhe në zona për të cilat kishin shpallur bllokimin, duke shkelur barazinë e individëve në ushtrimin e së drejtës së tyre kushtetuese për lirinë e shprehjes me mjete audiovizuale. Kjo përbën shkelje të parimit të mosdiskriminimit në gëzimin e lirive themelore të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe të neni 14 dhe Protokolli 12 të KEDNJ.

Me detyrimin dhe bindjen për të mbrojtur rendin kushtetues së Republikës së Shqipërisë dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, dhe të drejtat e individit të garantuara prej tyre, KKRT e re, me Vendimin nr. 517 datë 06.11.2006, "Për një ndryshim në Vendimet nr. 501 datë 17.07.2006 dhe nr. 143 datë 30.05.2003 të KKRT-së", vendosi të shfuqizojë këto akte :

- Pikën 7/c të Vendimit nr. 501 datë 17.07.2006 "Për zbatimin e detyrave që dalin nga Marrëveshja "Për planifikimin e Shërbimit të Transmetimeve Numerike Tokësore...(RRC-06)" dhe Marrëveshja "Për revizionimin e Marrëveshjes së Stokholmit 1961".
- Paragrafin e parë të pikës 3, të Vendimit nr. 143 datë 30.05.2003 "Për rregullimin e mëtejshëm të transmetimeve radiotelevizive".

Ndërkohë që KKRT, vendosi që të depozitonte një padi penale ndaj anëtarëve të KKRT -ve të mëparshme, që kishin ndërmarrë këto veprime në kundërshtim flagrant me legjislacionit kombëtar dhe instrumentet ndërkombëtare dhe që përbëjnë mohim të të drejtës themelore për lirinë e shprehjes dhe informimimit me mjete audiovizuale, çështje e cila tashme po ndiqet nga organet e prokurorisë. Pa paragjykuar në asnjë moment përfundimet e çështjes, shpresojmë dhe besojmë që Prokuroria do të vërtetojë që përbën një mjet efektiv për garantimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, në bazë të nenit 13 të KEDNJ.

Aktualisht, asnjë veprim i KKRT, në lidhje me dhënien, heqjen e licencave ose të sanksioneve eventuale nuk është bërë pa respektuar në mënyrë strikte legjislacionin në fuqi si dhe parimin e ligjshmërisë sado që, ky legjislacion rezulton të ketë nevojë të ngutshme për rishikime dhe plotësime.

### *ii. Reforma ligjore*

Kryerja e një reforme të plotë ligjore, është konsideruar dhe konsiderohet prioritare për vetë situatat dhe problematikat që ka shfaqur dhe shfaq legjislacioni ekzistues si në raport me standardet dhe praktikat e njohura ndërkombëtare si dhe me vetë zhvillimet teknologjike në këtë fushë. Për këtë arsye, kemi qenë gjithmonë të mendimit që çdo reforme ligjore apo amendim i legjislacionit ekzistues duhet të bëhej në konsultim të ngushte me të gjithë aktoret e përfshirë në fushën e medias, shoqërinë civile si dhe me partneret ndërkombëtare, me qellim që të gjitha ndryshimet e propozuara apo të miratuar të ishin në përputhje me standardet e njohura evropiane dhe më gjerë. Kjo reformë është drejtpërdrejt e sugjeruar edhe nga Bashkimi Europian në Grupin Konsultativ të Task Forcës të Qershorit 2006 si dhe në Raportin Vjetor të Progresit 2006.

Në këtë kuadër, kemi paraqitur edhe vërejtjet dhe sugjerimet tona në lidhje me ndryshimet e bëra në muajin janar 2007, me ligjin nr. 9677, date 13/01/2007, " për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, date 30/9/1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë",të ndryshuar, qëllimi i të cilave ka qenë funksionimi efikas i organit rregullator dhe përputhshmërinë e tyre me standardet e përmëndura më sipër. KKRT, ndërmjet të tjerash, nuk ishte dakord me formulimin e tille që "*KKRT e ushtron aktivitetin e tij nën mbikëqyrjen e Kuvendit*", pasi mënyra e formulimit të këtij neni vinte dhe vjen në kundërshtim me sugjerimin e Rekomandimit 2000 (23) të Këshillit të Europës në lidhje me pavarësinë e autoriteteve rregullatore në fushën e medias. Sipas këtij Rekomandimi kontrolli ndaj autoriteteve rregullatore duhet të jetë gjithmonë *a posteriori* dhe asnjëherë *a priori* sepse kjo mund të cënojë pavarësinë e institucionit.

Një çështje tjetër për të cilën KKRT kishte objeksionet e saj, kishte të bënte me quorumin dhe procesin e vendimmarrjes në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Sipas konceptit tonë, organet e pavarura votojnë gjithmonë me shumicë të thjeshtë. Në parim këtu qëndron lidhja e kolegjialitetit me pavarësinë e tyre.

Duke filluar që nga muajt Tetor-Nëntor e në vijim, KKRT ka punuar për të identifikuar të gjitha boshllëqet ligjore, problemet e hasura në praktikën e përditshme si dhe legjislacionin më të përparuar ndërkombëtar në këtë fushë, duke pasur si synim kryesor realizmin e një reforme ligjore të plotë dhe efikase. Pa synuar të zëvendësojë nismëtarët ligjorë dhe as ligjvënësit, KKRT është e gatshme që, në procesin e hartimit të ligjit të rishikuar të radios dhe televizionit publik dhe privat, të ofrojë vërejtjet dhe sugjerimet e saj me karakter teknik për garantimin sa më të saktë të lirisë së medias audiovizuale dhe të funksionimin e drejtë të tregut përkatës.

Në këtë kuadër, KKRT e vlerëson si të domosdoshme por edhe të vonuar në kohë nisjen e reformës ligjore në fushën e medias si dhe përfshirjen në të edhe të ekspertëve nga strukturat e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Europës, si një garanci më shumë në realizmin e saj brënda afateve të përcaktuara në planin e veprimit dhe kryerjen e kësaj reforme në përputhje të plote me standardet evropiane. Një ligj modern i cili parashikon liçensimin e teknologjive të reja dhe që ofron një treg më të larmishëm dhe pluralist audiovizual është i domosdoshëm për respektimin e standardeve europiane dhe detyrimeve kushtetuese si dhe për vijimin e suksesshëm të punës sonë.

Shprehim gjithashtu bindjen se realizimi i kësaj reforme, të monitoruar nga fillimi deri në fund të saj nga organizmat europiane, do ti japë fund një herë e mirë praktikave dhe eksperiencave negative ku ndryshimet apo amendimet ligjore të legjislacionit ekzistues në fushën e mediave janë bërë në funksion të interesave të klaneve apo grupimeve të caktuara mediatike apo të lidhura me interesa politike, gjë që kanë cënuar në mënyrë permanente konkurrencën e ndershme në tregun mediatik si dhe funksionin rregullator dhe pavarësinë e institucionit të KKRT-se.

Duke vlerësuar në tërësi planin e veprimit dhe hapat që duhet të ndiqen për kryerjen e një reforme të plote dhe të thelle ligjore, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit e konsideron kuptimplotë angazhimin që kërkohet nga Kuvendi i Shqipërisë dhe në veçanti nga Komisioni i Medias dhe Edukimit, për të siguruar transparencën maksimale në të gjitha fazat e proçesit të hartimit, përfshirë konsultimet publike me të gjithë aktorët kryesorë siç janë subjektet mediatike dhe shoqëria civile. Në këtë drejtim komunikimi që në muajin gusht 2006 i

Kryetares së Kuvendit me Komisionin Europian dhe Këshillin e Europës shënoi një hap të menjëhershëm në drejtimin e duhur por që duhet ndjekur me tempizmin e duhur, me masa konkrete ligjbërëse në mënyrë që reforma ligjore të realizohet brënda afateve optimale.

Shpresojmë dhe dëshirojmë që mbështetja nga aktoret ndërkombëtare, të vazhdojë me të njëjtin intensitet edhe në fazat e tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij legjislacioni në praktike dhe në fuqizimin dhe forcimin e kapaciteteve të nevojshme financiare dhe administrative për institucionet e përfshira drejtpërsëdrejti në zbatimin e tij.

Vlen të theksohet gjithashtu, se KKRT është duke punuar në përgatitjen dhe ratifikimin e dy Marrëveshjeve të rëndësishme, që rrjedhin nga Konferenca e Radio-komunikacioneve (RRC-04, të zhvilluar në Gjenevë, Maj-Qershor 2004), marrëveshje të cilat janë tashme të nënshkruar nga pala shqiptare dhe pritet vetëm ratifikimi i tyre. Ne këtë aspekt, janë hartuar projekt-ligjet "Mbi ratifikimin e Akteve Finale të Konferences Rajonale e Radio-Komunikacionit për planifikimin e shërbimit të transmetimit tokësor numerik në pjesët e Rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz", dhe "Mbi ratifikimin e Akteve Finale të Konferencës Rajonale e Radio-Komunikacionit për rishikimin e Marrëveshjes së Stokholmit(1961)". Këto projekt-ligje, janë dërguar për koment dhe opinion pranë institucioneve përkatëse kompetente, përpara se të shqyrtohen nga Këshilli i Ministrave e në vijim nga Kuvendi.

Ratifikimi i këtyre akteve, do t'i hapë rrugën hartimit dhe miratimit të Planit Kombëtar të Frekuencave, për të cilin do të ndalem në mënyrë të vecante më poshtë.

Në mënyrë që reforma ligjore në veçanti, por edhe të gjitha reformat e mbështetura në të, në përgjithësi, të bazohen në një logjikë zhvillimi dhe integrimi, KKRT është duke punuar për përgatitjen e një strategjie sektoriale të fushës audiovizuale. Një Strategji e tillë synon të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit të sektorit audiovizual në Shqipëri dhe po konsultohet edhe me operatorët e ndryshëm radio-televizivë.

### *iii. Reforma administrative*

Nisur nga prioritetet dhe angazhimet që rrjedhin nga ky proçes, që nga krijimi i Këshillit të ri Kombëtar të Radios dhe Televizionit, me vendimin e Kuvendit të Shqiperisë të *dates 28 Korrik 2006*, Institucioni e angazhoi veten në nisjen e një reforme të plote administrative dhe ligjore me synimin për të adresuar të gjitha

problematikat dhe shqetësimet e identifikuara në vazhdimesi nga aktoret dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, si prioritare u konsiderua vlerësimi dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative duke qenë se me burimet njerëzore ekzistuese KKRT e kishte dhe e ka të pamundur të realizojë në mënyrë të sukseshme dhe të plote detyrimet funksionale që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. Parë në këtë këndvështrim, nisur edhe nga praktikat dhe eksperiencat e vendeve të tjera anëtare ose të Bashkimit Evropian, u përgatit struktura e re e këtij institucioni e cila nëpërmjet fuqizimit të burimeve njërezore dhe kapacitete administrative do të bente të mundur monitorimin, zbatimin dhe adresimin e plotë të çështjeteve dhe problematikave të hasura gjatë gjithë këtyre viteve.

Kjo strukturë synon të angazhoje fuqimisht institucionin e KKRT, në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe standartet ndërkombëtare, për t'i dhën zgjidhjen efektive dhe kahjen e duhur një sërë problemeve të patrajtuara për shkak mungesash të kapaciteve të nevojshme, të neglizhuara apo të trajtuara në mënyrën jo të duhur deri me sot. përmes këtyre ndryshimeve, KKRT tenton të zgjidhë probleme që kanë të bejne *me respektimn e konkurrencës së ndershme në tregun mediatik, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së autorit, monitorimin më të mire dhe efikas të çështjeve që kanë të bëjnë me reklamat në media, problemet e etikes dhe moralit të programacioneve, luftën kunder piraterisë, respektimin e plotë të kritereve të liçensimit, monitorimin e transmetuesve, etj*. Struktura synon t'a bëjë KKRT gjithashtu më aktive edhe në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për pjesëmarrjen në projekte dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

Me vendimin nr.166, datë 11/12/2006, Kuvendi miratoi strukturën e re të paraqitur nga KKRT, duke rritur numrin e përgjithshëm të punonjësve nga 32 në 48, e cila nuk është bërë funksionale, pasi pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave klasifikimi i pagave si dhe ndryshimet përkatëse ligjore që do të bënin të mundur mbulimin e të gjithë elementëve financiarë të nevojshëm për këtë rritje të kapaciteteve administrative dhe njerëzore, dhe për rrjedhojë rekrutimin e nevojshëm të personelit.

Shndërrimi i Këshillit të Ankesave në një Këshill Etike që vihet në lëvizje edhe "ex officio" dhe jo vetëm me ankesë ka qenë një tjetër hap i rëndësishëm të ndërmarrë nga KKRT, nëpërmjet përfshirjes në të personaliteteve nga shoqëria civile, me integritet të plotë moral dhe profesional, detyra e të cilëve është sensibilizimi i opinionit publik për të përgjegjësuar entet radiotelevizive publike dhe private që të realizojnë normat etike dhe morale në programet e tyre. Ky vizion mbështetet në konceptimin që institucionet jo vetëm duhet të ndjekin preferencat e publikut në lidhje me aspekte etike të medias sonë, por nëpërmjet

profesionalizmit dhe gjykimit të specializuar edhe ta drejtojnë shoqërinë drejt standarteve më të larta.

Një vëmendje të veçantë ka pasur edhe organizimi i brendshëm sa më funksional i KKRT, gjë që është konkluduar me miratimin e disa akteve rregullatore në lidhje me harmonizimin dhe organizimin e punës si dhe të administrimit mbledhjeve të KKRT, e cila ka disiplinuar dhe përmirësuar më tej veprimtarinë e këtij institucioni. Vlen të përmendet gjithashtu futja e një praktike të re raportimi sipas të cilës të gjitha Departamentet e KKRT raportojnë në bazë mujore për respektimin e kritereve ligjore dhe rregullatore nga gjithë operatorët radiotelevizivë dhe për të gjithë spektrin e frekuencave. Kjo mënyrë lejon një trajtim shumë më të drejtë dhe aspak diskrecionar të të gjitha subjekteve. Po bëhen përpjekje që këto mënyra raportimi të bëhen publike edhe në faqen e internetit të KKRT.

Shqetësim i vazhdueshëm mbetet pajisja me mjedise të reja pune të cilat mund ti garantojnë institucionit një funksionim normal. Në këtë drejtim jemi në kontakte me KDRTSH dhe mbështetja e Kuvendit dhe e Këshillit të Ministrave në këtë drejtim na japin shpresë për një zgjidhje përfundimtare të këtij problemi. Ndërkohë institucioni është pajisur edhe me një faqe të re interneti, duke zëvendësuar të vjetrën që nuk arrinte të plotësonte as standardet më minimale të komunikimit.

## C. *Bashkëpunimi ndër-institucional*

Një aspekt shumë i rëndësishëm i punës së KKRT gjatë kësaj periudhe, ka qenë institucionalizimi i bashkëpunimit me institucione të tjera, fusha e veprimtarisë të së cilave , konvergon me legjislacionin në fushën e mediave. Qëllimi i institucionalizimit të këtij bashkëpunimi ka synuar një angazhim më të madh ndër-institucional për zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji 8410, ligji "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për Kinematografinë", i ndryshuar, Ligji "Për konkurrencën" si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, KKRT ka arritur të institucionalizojë bashkëpunimin me:

### *i. Me Autoritetin e Konkurrencës*

Duke vlerësuar me një përgjegjësi profesionale nenin 20 të Ligjit 8410 të sipër cituar, i cili në dispozitën e vet synon të ndalojë përqëndrimet në media, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, që në tetor 2006 filloi përgatitjen dhe negociatat për nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, i cili u nënshkruar mes palëve, më datë

15.12.2006, dhe parashikon bashkëpunimin mes dy autoriteteve me qëllim zbatimin e rregullave të konkurrencës në tregun mediatik. Mënyra e rregullimit të tregut në BE dhe në vendet anëtare të tij ka qenë shembulli i përdorur për këtë zgjidhje institucionale. Ky është rasti i parë që në Shqipëri përdoret një proçedurë e tillë garantuese për konkurrencën e lirë mediatike në Shqipëri.

*ii.* ***Me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë***

Kjo u arrit nëpërmjet nënshkrimit të një Memorandumi Bashkëpunimi, datë 27/02/2007, qëllimi i së cilës është përcaktimi i modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit për forcimin e luftës kundër piraterisë kinematografike si dhe respektimit të të drejtave të autorit.

*iii.* ***Me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Entin Rregullator të Telekomunikacioneve***

Kjo u arrit nëpërmjet një Marrëveshjeje Bashkëpunimi. date 15/03/2007, qëllimi i se cilës është mbështetja e strukturave të KKRT, gjatë ushtrimit të detyrimeve dhe kompetencave ligjore për mbikëqyrjen, inspektimin, dhënien e masave administrative dhe ekzekutimin e vendimeve, ndaj subjekteve që shkelin legjislacionin në fushën e mediave, kushtet e liçensës dhe rregulloret përkatëse.

*iv.* ***bashkëpunimi me institucione të tjera***

Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është duke punuar intensivisht për të institucionalizuar bashkëpunimin edhe me institucione dhe struktura të tilla si Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim forcimin e bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit, regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore të të punësuarve në subjektet mediatike, shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit me zyrën e regjistrit tregtar në lidhje me subjektet e liçensuara në fushën mediatike, etj.

*v.* ***bashkëpunimi me mediat***

Në kuadrin e hartimit të një strategjie sektoriale dhe të ndryshimeve ligjore, KKRT ka konceptuar dhe ndërkaq ka filluar një tur konsultimesh individuale me të gjithë operatorët mediatikë, edhe për të parë konkretisht kushtet e tyre të punës, problemet që kanë në funksionimin e tyre dhe për të diskutuar drejtimet e zhvillimit të fushës në Shqipëri.

### *vi. Bashkëpunimi me shoqërinë civile*

KKRT ka intensifikuar kontaktet me shoqërinë civile në lidhje me aspekte specifike të veprimtarisë së saj. Për t'u përmendur është bashkëpunimi me Institutin Shqiptar të Medias në një projekt që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga media në Shqipëri.

## *D. Bashkëpunimi Ndërkombëtar*

KKRT e konsideron forcimin e bashkëpunimin ndërkombëtar, të një rëndësie primare në njohjen e praktikave, eksperiencave dhe standardeve më të mira evropiane në fushën e medias. Vetë procesi i integrimit evropian , është një mekanizëm nxitës që të çon drejt përqasjes me standardet dhe praktikat më të mira në këtë fushe. Si rrjedhojë, vlerësohet si e një rëndësie themelore, thellimi i bashkëpunimit dhe përfshirja apo angazhimi i drejtpërdrejtë në reformën ligjore të Komisionit Evropian, Këshillit të Europës, si dhe Komisionit të Venecias, si strukturat që konsiderohen si "prodhuesit" e standardeve europiane në fushën e mediave.

KKRT ka thelluar më tej bashkëpunimin me OSBE, duke e konsideruar këtë institucion si një nga mbështetësit permanentë të institucioneve shqiptare në këtë fushë, nëpërmjet dhënies se ekspertizës dhe njohjes me praktikat europiane dhe ndërkombëtare. Një vlerë të veçante kanë pasur edhe kontaktet në nivel bilateral, me shumë autoritete rregullatore të vëndeve të ndryshme europiane, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave dhe njohjes së praktikave më të mira në këtë fushë, si dhe pjesëmarrjes në disa aktivitete të organizuara nga Autoritetet Europiane të tilla si EPRA, Autoriteti Audiovizual Europian, EBU, dhe së fundi janë vendosur kontaktet edhe me Motion Pictures Association.

# *III. SITUATAT, PROBLEMET DHE PRIORITETET NE FUSHAT SPECIFIKE*

## *A. Rezultatet e arritura në fushën e liçensimit*

### *i. Dhënia e Liçensave*

Gjatë vitit 2006 dhe fillim viti 2007, janë liçensuar 21 subjekte, nga të cilat: 7 për transmetim TV vendor, 12 për transmetim TV kabllor, 2 për transmetim radio FM vendore, si më poshtë:

- Radio Logos (Pogradec)
- Radio X (Fier)

- TV AlbWest (Vorë)
- TV Blu Sky (Shkodër)
- TV Durrësi (Durrës)
- TV Fokus (Vlorë)
- TV Kabëll Ali Pashë Tepelena (Memaliaj)
- TV Kabëll ERI A&A (Ballsh)
- TV Kabëll Blu (Golem)
- TV Kabëll DI-TV (Tiranë)
- TV Kabëll Erzeni (Shijak)
- TV Kabëll IR-Gen (Gjirokastër)
- TV Kabëll K.A.M (Peqin)
- TV Kabëll Mirdita (Mirditë)
- TV Kabëll Synej (Komuna Synej-Kavajë)
- TV Kabëll Tepelena-Sat (Tepelenë)
- TV Kabëll TV Memaliaj
- TV Kabëll Ura Vajgurore
- TV ORA (Tiranë-Durrës)
- TV Përmet (Përmet)
- TV Saranda (Sarandë)

### *ii. Rinovimi i Licencave*

Subjektet të cilëve iu është rinovuar liçensa gjatë vitit 2006 janë si më poshtë :

- Alfa&Omega
- Club FM
- Magic Star
- Radio "Ngjallja"
- Radio +3 (Fier)
- Radio BBC (përsëritës)
- Radio Deutsche Welle (përsëritës)
- Radio Eurostar (Tiranë)
- Radio House of Arts (Tiranë)
- Radio Ime
- Radio Italia (përsëritës)
- Radio Oxygen
- Radio Saranda
- Top Gold
- TV 5 (përsëritës)
- TV 6+1 (Vlorë)
- TV A1 (Tiranë)
- TV ARV (Pogradec)

- TV Dardan (Elbasan)
- TV Gramshi (Gramsh)
- TV Koha (Tiranë)
- TV Kristal+ (Korçë)
- TV Kruja (Krujë)
- TV Lezha (Lezhë)
- TV Mirdita (Mirditë)
- TV Sot 7 (Pogradec)
- TV Telesport (Tiranë)
- TV TOP Channel (Tiranë)
- TV Vizion + (Tiranë)

Për subjektet TV Koha, TV Telesport, Top Channel, TV Vizion +, të cilët kanë impiante transmetimi jashtë zonave të liçensimit, rinovimi i liçensave është kryer vetëm për zonat e liçensimit sipas liçensave përkatëse të miratuara nga KKRT në momentin e liçensimit.

### *iii. Mosrinovimi i liçensave*

Këshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit ka marrë vendimin për mosrinovim liçense për subjektet e mëposhtme, për shkak të mosrespektimit të kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga ligji:

- Radio Fantazi
- Radio Koha (Tiranë)
- TV Antena Jug (Gjirokastër)
- TV BBF (Tiranë)
- TV Real (Durrës)
- TV TNSH (Tiranë)

Duhet të theksohet fakti që, në zbatim të nenin 7 (pika 12), ku theksohet "*...KKRT mban rregjistrat, skedat dhe arkivin e liçensave si dhe dokumentacionin që lidhet me to, duke pasqyruar të gjitha ndryshimet e mëvonëshme*". Për herë të parë që nga funksionimi i ketij institucioni, me anë të një pune intensive të Departamentit Juridik dhe të Liçensave u respektua ky detyrim ligjor nëpërmjet krijimit të Rregjistrit të liçensave dhe dosjeve përkatëse për të gjithë operatorët radio-televizive që operojnë në tregun mediatik.

### *iv. Liçensimi i subjektit "Ora" Sh.P.K*

Zhbllokimi i tregut të dhënies së liçensave si dhe kërkesat e vazhdueshme nga persona fizikë dhe juridikë, bënë që pas vlerësimit teknik të gjëndjes së frekuencave, si dhe pretendimet disa vjeçare për akordim frekuencash në zona të caktuara, KKRT, me Vendimin nr. 518 datë 06.11.2006 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë", vendosi të shpallë në mënyrë publike konkurrimin e kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë për zonat: Qyteti i Sarandës dhe Rrethet Tiranë +Durrës.

Njoftimi për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë televizivë, krahas botimit në gazetat e përditshme "Tema" në datat 09-10.11.2006, " Gazeta Shqiptare" në datat 08-09.11.2006, si dhe transmetimit në TVSH, iu dërgua të gjithë subjekteve të cilët kishin depozituar letrat e interesit në KKRT, që nga viti 2004 e në vazhdim. Kjo ishte një masë që synonte të kthente në vend të drejtën e mohuar të gjitha subjekteve që kishin aplikuar për liçensë televizive në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës dhe me frymën dhe dispozitat e Ligjit nr. 8410 të sipërcituar.

Pavarësisht zhurmës dhe reagimeve tendencioze në disa media, KKRT shpreh bindjen e plotë se e gjithë proçedura për vlerësimin e aplikimeve në lidhje me këto dy frekuenca u zhvillua në përputhje të plotë me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

Me qëllim zbatimin efecient të rregullave të konkurrencës në tregun mediatik dhe në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës të përmendur më lart, KKRT çmoi të arsyeshme që para se të merrte një vendim në lidhje këtë liçensim, të këshillohej paraprakisht me Autoritetin e Konkurrencës, nëse marrja në shqyrtim e kërkesave në fjalë ishte apo jo në përputhje të plotë me rregullat e konkurrencës në fushën e mediave elektronike. KKRT iu drejtua, me shkresën nr. 1282, datë 22.12.2006, edhe Zyrës së Regjistrit Tregtar të Gjykatës së Tiranës, me qëllim identifikimin e ndonjë problemi të ngjashëm. Theksojmë se kjo praktikë e detajuar për zbatimin e rregullave konkurrenciale audiovizuale zbatohet për herë të parë në Shqipëri që nga krijimi i KKRT-së.

Për subjektet e kualifikuara, Komisioni Shqyrtimit të Dokumentacionit proçedoi me shqyrtimin dhe vlerësimin tërësor të aplikimeve, të cilat, në përfundim, iu paraqitën KKRT-së për vendimmarrje.

Më datën 28.12.2006, KKRT pas shqyrtimit të dosjeve të paraqitura, vendosi të liçensojë subjektet "Saranda-TV" sh.p.k. dhe "ORA" sh.p.k. Ndërsa për subjektet "Parma-Saralb" sh.p.k., "ABC news" sh.p.k. dhe "Tele Joni" sh.p.k., KKRT vendosi mosdhënien e liçensës.

KKRT sqaron se debati për liçensimin e televizionit "ORA", të televizionit "ABC news" apo të çdo televizioni tjetër lokal në zonën Tiranë-Durrës frymëzohet nga interesa të ngushta biznesi të sipërmarrjeve të caktuara mediatike dhe nga rezistenca e KKRT për të mos u hapur rrugë kërkesave të kundraligjshme të këtyre sipërmarrjeve. Në qoftë se elementët e referuar në media, por të paprovuar zyrtarisht nga KKRT apo nga institucionet e tjera shtetërore, brenda kompetencave përkatëse, do të përbënin shkak për refuzimin e liçensës apo heqjen e saj, kjo sipas mendimit të KKRT do të përbënte shkelje të drejtës së individit për të aplikuar dhe eventualisht pajisur me liçensë radio/tv. Për aq kohë sa pretendimet në faqet gazetareske nuk provohen institucionalisht, bazueshmëria thjesht në to, do të përbënte shkelje të parimit të shtetit ligjor. Megjithatë pretendimet e ngritura në shtyp në lidhje me këtë çështje janë shkas për një vlerësim të kujdesshëm të ndryshimeve të ardhshme ligjore në fushën audiovizuale, pa harruar nevojën që ata që marrin përsipër të shkruajnë ose të shprehen në lidhje me këtë fushë të përmbushin një kriter themelor të lirisë së shprehjes - përgjegjshmërinë profesionale.

## *B. OPERATORET PRIVATE RADIO TELEVIZIVE DHE TV. PUBLIK*

« Ka një progres për t'u raportuar në fushën e politikës audiovizuale. Rrëzimi i projektligjit mbi transmetimet digitale ishte një hap pozitiv, pasi ai përmbante amendime, të cilat, nëse do të ishin miratuar, mund të kishin krijuar një situatë monopoli. Tani, Shqipëria duhet të ndërmarrë hapat e duhur për miratimin e legjislacionit për shërbimet digitale dhe median elektronike në përputhje me standardet europiane dhe të nisë procesin e përputhjes së legjislacionit të saj me Konventën Europiane mbi Televizionin Ndërkufitar dhe Direktivën e Televizionit Pa Kufi. Gjithashtu, autoritetet shqiptare duhet të përmbledhin diskutimet mbi projektstrategjinë për zhvillimin e transmetimeve televizive dhe të finalizojnë Planin Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Shqipëria duhet të vazhdojë gjithashtu forcimin e kapacitetit administrativ të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, në mënyrë që të mund të monitorojë dhe të zgjidhë në mënyrë të përshtatshme problemet në lidhje me grumbullimin e pagesave të transmetimit nga disa transmetues privatë, duke shmangur çdo diskriminim midis transmetuesve ».[1]

Rekomandim i mësipërm i dhënë nga Raporti i Progresit i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2005 që vlerësoi hapat në drejtimin e duhur të realizuara në fushën e rregullimit të mediave gjatë vitit të vështirë elektoral 2005, me gjithë

---

[1] **Raporti i Progresit i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2005 (3.2.6. Shoqeria e Informacionit dhe media)**

përpjekjet e vazhdueshme të KKRT edhe gjatë vitit 2006 nuk gjeti mbështetjen e duhur. Për pasojë, miratimi i legjislacionit për shërbimet numerike (digitale) dhe përmbledhja e diskutimeve për projektstrategjinë për zhvillimin e transmetimeve televizive mbeten dy detyrat kyç për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, në kuadrin e përpjekjeve të gjithë vendit për arritjen e standardeve të antarësimit në Europë.
Në zbatim të misionit të tij, edhe gjatë vitit 2006 Këshilli ka vazhduar përpjekjet konkrete për finalizimin e Planit Kombëtar të Frekuencave Televizive nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në hartimin e Planit të Frekuencave Numerike të Rajoneve 1 dhe 3 të realizuar në Konferencën e Radiokomunikacioneve, Gjenevë, Qershor 2006 që u kurorëzua me nënëshkrimin e marrëveshjes GE06[2] dhe revizionimin e marrëveshjes ST61[3].

### *Televizioni publik shqiptar*

*"Programet e RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 përqind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë.*

*Brenda 5 vjetësh nga dita e miratimit të këtij ligji, të paktën njëri nga programet e RTSH-së duhet të mbulojë 99 përqind të popullsisë".*[4]

RTSH mbulon me një program (programi I) të mbështetur në transmetues të teknikës analoge 73.31 % të territorit shqiptar. Ky mbulim realizohet kryesisht me stacione transmetues që operojnë në brezin VHF[5] dhe që shërbejnë si një rrjet primar për një numër përsëritësash në brezin VHF dhe UHF[6]. Kohët e fundit, nga RTSH, pa njoftuar KKRT dhe në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 që përcakton se transmetimi fillon vetëm pas inspektimit teknik të projektit dhe pajisjeve, janë futur në shfrytëzim në pika të ndryshme të vendit (Durrës, Ishëm, Tiranë (Dajt) disa stacione transmetues në brezin UHF. Kjo ka bërë që në disa pika (më e spikatura dhe më problematikja, pika e Dajtit) RTSH të jetë e pranishme me më shumë se një transmetues. Aktualisht RTSH në pikën e Dajtit ka instaluar :

1. Transmetuesin e akorduar në kanalin 11 VHF;
2. Transmetuesin e akorduar në kanalin 57 UHF;

përveç transmetuesit në bandën C që përdoret për të furnizuar me sinjal primar një numër përsëritësash

[2] Marrëveshje e nënëshkruar në Konferencën Rajonale të Radiokomunikacioneve (RRC-06), Gjenevë, 16 Qershor 2006.
[3] Marrëveshje e nënëshkruar në Konferencën Rajonale të Radiokomunikacioneve (ST-61), Stokholm, 1961
[4] Ligji "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republiken e Shqipërisë", neni 71
[5] VHF (Very High Frequency)-Frekuencë Shumë e Lartë (Ne kete material i referohet brezit 174-230 MHz.
[6] UHF (Ultra High Frequency)- Frekuencë Ultra e Lartë (Në brezin 470- 862 MHz)

duke mbuluar zonën e shërbimit me të paktën 3 kanale frekuencore që transmetojnë të njëjtin program. KKRT është e mendimit që përdorimi i më shumë se një frekuence për të mbuluar të njëjtin territor, përbën një luks të pajustifikueshëm, qoftë edhe për operatorin publik, pasi shpërdorohet një pasuri e kufizuar kombëtare.

Ligji nr.8410 (Neni 148) përcakton:

*"Të gjitha frekuencat në përdorim të RTSh-së, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten në dispozicion të këtij institucioni për një periudhë 10-vjecare".*

Ligji nuk përmban dispozita për dhënien preferenciale të frekuencave për operatorin publik. KKRT, i vetëdijshëm për rolin, rëndësinë dhe gjëndjen aktuale të RTSH, është përpjekur t'i krijojë atij të gjitha hapësirat e mundëshme të lejuara me ligj, në mënyrë që ai ta plotësojë misionin e vet për informimin, edukimin dhe argëtimin e publikut të gjerë. Por KKRT kurrsesi nuk pajtohet me vazhdimin e praktikës së transmetimeve të paautorizuara që po hedh poshtë të gjitha përpjekjet për vendosjen e rregullit në administrimin e frekuencave. Ajo që e rëndon më tepër problemin është se të gjithë stacionet transmetues që janë instaluar pa leje, nuk kanë ndikuar në zgjerimin e zonës së mbulimit (mbulimi ka mbetur në 73.31 % po aq sa vitin e kaluar), por ato thjesht dublojnë apo shumëfishojnë mbulimin ekzistues.[7]

Për këtë KKRT i është drejtuar zyrtarisht RTSH duke e ftuar të bashkëpunojë për zgjidhjen e problemeve. Ndër problemet kryesore mbetet çelja e programit të dytë të parashikuar nga ligji. KKRT i rekomandon Këshillit të ri Drejtues të ndërmarrë hapa për kristalizimin e një strategjie zhvillimi për këtë institucion të rëndësishëm.

Me kohë[8], KKRT ka sugjeruar shqyrtimin e mundësisë që, në vend të ndërtimit të rrjetit analog për programin e dytë të RTSH, të planifikohet ndërtimi i një rrjeti numerik, mbi të cilin do të mbështeten, programi i parë dhe programi i dytë duke krijuar njëkohësisht mundësinë e transmetimit të disa programeve tematikë. Një zgjidhje e tillë do të përmirësojë cilësinë e transmetimit, do të rritë kapacitetet e RTSH, duke kontribuar në përshpejtimin e kalimit në transmetimet numerike në Shqipëri.

Propozohej që shqyrtimi, i shoqëruar me një studim fizibiliteti të kryhej nga vetë specialistët e RTSH, të mbështetur edhe në ekspertizë të huaj.

---

[7] Bashkëngjitur jepen tabelat e mbulimit me sinjal deri në fund tëvitit 2006. Për mbulimin e RTSh janë dhënë dy tabela. Tabela e dytë paraqit gjendjen e realizuar nga stacionet UHF. Nga krahasimi i tabelave rezulton se mbulimi i transmetuesave pa leje nuk ka sjellë asnjë përmirësim në zonat problematike Devoll, Kolonjë Përmet

[8] Sih "Raport i KKRT per vitin 2004", pika 7

Nga informacionet që disponon KKRT, nuk rezulton të jetë marrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim. KKRT mendon se Këshilli i ri Drejtues i RTSH duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar një zhvillim të harmonizuar të rrjeteve dhe programeve të tij, në përputhje me misionin dhe objektivat e veçanta si operator publik.

KKRT vazhdon të theksojë se kusht kryesor për stabilizimin e gjendjes financiare të Operatorit publik, që do të siguronte plotësimin e misionit dhe objektivave të tij, është përmirësimi i skemës së financimit. Kjo do të rriste interesimin e vetë RTSH si për mbledhjen e kësaj takse, ashtu edhe për përcaktuar nivelin e saj. Kjo do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e gjëndjes ekonomike të RTSH, në kushtet kur qytetarët tashmë po mësohen të paguajnë për shërbimet radio apo televizive.

Një efekt tjetër pozitiv i këtij përmirësimi, do të ishte forcimi i pavarësisë së operatorit publik nga strukturat shtetërore, për të cilën kanë shprehur vërejtjet e tyre shumë konsulentë të huaj.

Një burim të ardhurash për RTSH përbën edhe dhënia me qira e ambienteve dhe infrastrukturës tjetër (kulla, etj). Në përpjekje për të maksimizuar të ardhurat, RTSH, përpiqet të sigurojë kushte financiare sa më të favorshme gjatë lidhjes së kontratave me të tretët, sidomos me operatorët privatë radio apo televizive. Për të shmangur abuzimin me pozicionin dominant, ligji 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar (neni 14), ngarkon KKRT-në të bëjë miratimin e tarifave të caktuara nga RTSH.

Për këtë qëllim, KKRT ka miratuar rregulloren „Për përdorimin e ambienteve të RTSH-së nga subjektet private radio e televizive"[9], që përcakton proçedurën, kriteret dhe kushtet për miratimin e tarifave. Drejtoria e Përgjithshme e RTSH para dy vjetësh ka depozituar pranë KKRT tarifat që ajo aplikon, pa i shoqëruar ato me argumentimet teknike mbi kriteret e përdorura e llogaritjet përkatëse që do të justifikonin madhësinë e këtyre tarifave. Me fillimin e punës nga Këshilli i ri kjo çështje po merr rrugë. Kohët e fundit Nga RTSH janë paraqitur në KKRT tarifat e reja që RTSH mendon të aplikojë për të tretët, të shoqëruara me argumentimin ekonomik përkatës, gjë që stafi i vjetër ka munguar ta bëjë për një kohë të gjatë.

### *i. Operatorët Kombëtarë*

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e liçensës së secilit prej tyre.

[9] Vendimi nr 217 date 26.02.2004 i KKRT

| Nr. | Operatori | Zona e Licencimit | Mbulimi | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Dhjetor 2002 Viti II | | Dhjetor 2003 Viti III | | Dhjetor 2004 Viti IV | | Dhjetor 2005 Viti V | | Dhjetor 2006 Viti VI | |
| | | | Kushtete licenc. | Mbulimi faktik | Kushtete licenc. | Mbulimi faktik | Kushtete licenc. | Mbulimi faktik | Kushtete licenc. | Mbulimi faktik | Kushtete licenc. | Mbulimi faktik |
| 1 | TVSH | K | - | 73,31 | - | 73.31 | - | 73.31 | | 73.31 | | 73.31 |
| 2 | TV ARBËRIA | K | 7,33 | 27,39 | 26,4 | 30,1 | 46,97 | 30,1 | 62.09 | 30.1 | 75.71 | 30.1 |
| 3 | TV KLAN | K | 7,33 | 40,91 | 26,4 | 42,68 | 46,97 | 42,68 | 62.09 | 42.68 | 75.71 | 44.53 |
| 4 | R. TIRANA | K | - | 80,54 | - | 80,54 | - | 80,54 | | 80.54 | | 80.54 |
| 5 | R. T.ALB. | K | 28,85 | 87,22 | 55,76 | 87,22 | 72.69 | 87,22 | 94.4 | 87.22 | 100 | 87.22 |
| 6 | RADIO +2 | K | - | - | 55,76 | 72,64 | 72,69 | 72,64 | 94.4 | 72.64 | 100 | 72.64 |

- Mbulimi i RTSH është dhënë i pandryshuar në vite, pasi nuk janë raportuar apo identifikuar ndryshime të rrjetit bazë të transmetimit, Vënia në punë e stacioneve në UHF ka dubluar mbulimin në zona tashmë të mbuluara dhe nuk e ka zgjeruar atë në zona të largëta..
- Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB (μV/m),

Edhe gjatë vitit 2006 ka vazhduar tendenca për zhvillimin e shërbimeve të reja numerike (satelitore e tokësore) në dëm të plotësimit të detyrimeve të liçensës. Tabela e mësipërme vërteton tendencën e konstatuar vitet e kaluara[10] lidhur me përqendrimin e vëmendjes së pronarëve të disa rrjeteve televizive analoge tokësore në zhvillimin e transmetimeve numerike (tokësore e satelitore), të shoqëruara me investimet përkatëse. Kjo ka krijuar diferenca midis mbulimit të parashikuar në kushtet e liçensave dhe atij të realizuar. Nuk bëjnë përjashtim as operatorët radio kombëtare, megjithëse mbulimi i realizuar prej tyre, për vetë karakteristikat e valëve të brezit FM, është relativisht i lartë në krahasim me operatorët televizivë.

[10] Shih Raportet e KKRT per vitin 2004 e 2005.

TV Klan ka shënuar një rritje shumë të vogël të mbulimit (1.85%), por gjithsesi, diferenca kundrejt detyrimit ligjor mbetet e madhe.
Mosrealizimi i kushteve të vendosura në liçensë për mbulimin me sinjal nga TV ARBERIA vazhdon të jetë i ndjeshëm (Diferenca midis mbulimit të përcaktuar në kushtet e liçensës me mbulimin faktik të realizuar është 45.6%.Për këtë operator, shifra e mbulimit mbetet ajo e realizuar në fund të vitit 2005. Në këtë gjendje kanë ndikuar edhe ndryshimet e shpeshta të pronësisë mbi këtë subjekt, që kanë sjellë ndryshime të shpeshta të politikave të zhvillimit.
Sic rezulton nga tabela e mësipërme edhe operatorët radio privatë kombëtarë nuk i kanë realizuar detyrimet për mbulimin në përputhje me kushtet e liçensës.

Viti 2006 ishte viti i gjashtë i liçensimit të operatorëve kombëtarë.
Ligji "Per radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" (Neni 20), përcakton:
***"Mbajtësi i liçensës për transmetim radioteleviziv kombëtar duhet të realizojë mbulimin e mbi 70 % të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh ky mbulim duhet të arrijë të përfshijë deri në 90 % të territorit dhe jo më pak se 90 % të popullsisë".***

Mosrealizimet e detyrimeve të mbulimit të territorit nga ana e operatorëve kombëtarë, vërtetuan dyshimin e shprehur në Raportin e KKRT për vitin 2005. Ndërsa ligji përcakton objektivat për mbulimin e territorit, ai nuk përcakton sanksione për mosrealizimin e këtyre objektivave. Nga ana e KKRT, operatorët përkatës janë paralajmëruar disa herë që këto mosrealizime do të merren në konsideratë gjatë shqyrtimit të rinovimit të liçensës (që do të realizohet në vitin 2008).

Ndërkaq objektivi i mbulimit vazhdon të jetë kryesisht mbulimi i zonave që kërkojnë më pak investime dhe ku ekziston interes për thithjen e reklamave duke lënë pa mbulim me sinjal zona të largëta, ku mungojnë edhe operatorët vendorë.
Sipas kushteve të liçensës,

***(1) I liçensuari duhet të realizojë lidhje stacionare radiorele me jo më pak se 4 (katër) qytete të Shqipërisë të cilët ndodhen jo më pak se 100 km larg Tiranës.***

***(2) Këto lidhje duhet të realizohen jo më vonë se 18 muaj nga koha e fillimit të transmetimit.(Detyrimi për lidhje me disa rrethe të Shqipërisë)***

TV Klan ka informuar se ai tashmë ka ndërtuar studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.

Siç është raportuar edhe vitet e kaluara, këto kushte të liçensës vazhdojnë të mos plotësohen nga të dy operatorët televizivë privatë kombëtarë dhe të dy operatorët radio FM kombëtare.

KKRT i përmbahet idesë se edhe këto mosrealizime do të jetë një kusht penalizues gjatë proçesit të riliçensimit.

Informacioni mbi shtrirjen dhe cilësinë e mbulimit të territorit të secilit nga operatorët privatë kombëtare, jepet bashkëngjitur.

### ii. Operatorët Vendorë/ Operatorët e rinj vendorë

Për vetë gjendjen e ngarkuar të shfrytëzimit të spektrit me transmetime të teknikës analoge, edhe gjatë vitit 2006, në përputhje me kërkesat e paraqitura, KKRT është përpjekur të orientojë ngritjen e operatorëve vendorë radio dhe televizive në zonat e largëta ku nevojat për informacion e argëtim në gjuhën shqipe janë më të mëdha dhe ku shfrytëzimi i spektrit nuk është i ngarkuar. Nuk ka munguar edhe vullneti i KKRT për të lëshuar liçensa operimi edhe në zonat e ngarkuara, në favor të nxitjes së konkurrencës së ndershme dhe për të shmangur monopolet. Por duhet theksuar se megjithë përpjekjet e KKRT për krijimin e lehtësirave, për nxitjen e mbulimit të zonave të largëta, nuk kanë dhënë gjithmonë rezultatin e pritur. Është për t'u përmendur rasti i operatorit radio dhe TV " Armonia" i konceptuar si media për zonën e minoritetit grek në jug të Gjirokastrës i cili akoma nuk ka dalë në transmetim me gjithë nxitjet e shpeshta të KKRT-së.

Në përpjekje për të realizuar, mundësisht të gjitha kërkesat për t'u liçensuar si operatorë vendorë radio e televizive, KKRT ka organizuar kandidime kandidaturash dhe ka lëshuar liçensa te reja si operatorë radio apo televizive, kryesisht operatorë të vegjël lokalë, ose zgjerime të vogla të operatorëve ekzistues, megjithë vështirësitë e mëdha që ka paraqitur mungesa e Planit Final të frekuencave.

### *iii.* Mbulimi i realizuar nga operatorët vendorë radio e televizivë

Informacioni për mbulimin e realizuar nga secili prej operatorëve radio apo televizivë të liçensuar, jepet bashkëngjitur.
Në përgjithësi, shumë prej operatorëve të liçensuar, sidomos ata televizive, nuk i mbulojnë plotësisht zonat e tyre të liçensimit.
Operatorët që rezultojnë me mbulim më të ulët janë:

Tv Gramshi-7.2 % (I njëjtë me vitin e kaluar)

Tv Berati-6.2 % (I njëjtë me vitin e kaluar)

Operatorët që mbulojnë deri në 70 %:

Tirana TV- 42%,

Adriatik 61 %,

Vizion+ 54.69%,

Televizione me mbulim të mirë (Mbi 70%)

Teuta TV 78.3 % si dhe disa TV të vogla ,(TV 4+, Klodiana e Magic Channel)
Këtë vit nuk ka operatorë që kanë përmirësuar ndjeshëm mbulimin me sinjal të zonës së tyre të liçensimit
Në fushën e transmetimeve radio, për vetë karakteristikat e përhapjes së sinjalit në brezin e FM, mbulimi i zonës së liçensimit paraqitet më i mirë.

### *iv. Operatorët që kanë instaluar stacione jashtë zonës së tyre të liçensimit*

Bashkëngjitur jepet skematikisht gjëndja e mbulimit të realizuar nga të gjithë operatorët radio e televizive të liçensuar. Siç mund të shihet edhe nga krahasimi me të dhënat e vitit të kaluar, gjëndja e transmetimeve jashtë zonës së liçensimit nuk ka ndryshuar shumë.

Kjo evidenton përpjekjet e sforcuara e pa kompromis të KKRT për ta mbajtur gjëndjen nën kontroll te rreptë, pasi gjatë vitit 2006 tentativat e individëve të liçensuar ose jo për të sfiduar ligjin duke zgjeruar arbitrarisht zonën e liçensimit apo për të instaluar impiante pa leje, nuk kanë munguar, përkundrazi, në ndonjë rast, duke përfituar nga situata e krijur nga ndryshimi i Këshillit, janë shumëfishuar. Si pasojë e luftës pa kompromis të zhvilluar nga KKRT, gjatë vitit 2006 janë mbyllur një numër impiantesh pa leje dhe janë gjobitur shumë subjekte duke siguruar mbajtjen e një regjimi të stabilizuar, ndonëse me probleme. Këtu veçojmë masat e ndërmarra kundrejt TVA1 (Tv Ballkan), ALSAT, TV Apollon. Në të gjitha rastet, KKRT ka vepruar me vendosmëri dhe e mbështetur nga organet e Ploicise tatimore, ka ndërmarrë masat dhe sanksionet e parashikuara nga ligji, për të siguruar që në territorin e Shqipërisë veprimtaria radio televizive të zhvillohet në përputhje me ligjin, sipas një liçense të lëshuar nga Autoriteti Rregullator duke i u nënështruar proçesit të konkurrimit të kandidaturave dhe jo në bazë të dëshirave të shkelësve të ligjit.

Gjatë 2006 u riliçensuan edhe shumë nga operatorët që kanë instaluar impiante jashtë zonës së liçensimit. Riliçensimi i tyre u realizua me kusht që ata të mbyllin të gjitha impiantet e instaluara jashtë zones së liçensimit brenda 31 Dhjetorit 2006. Në rast se kushti nuk zbatohet, KKRT ka të drejtë të realizojë mbylljen me forcë.

Këtë vit janë konstatuar edhe raste të instalimit të pajisjeve transmetuese nga persona të pa liçensuar. Një rast flagrant përbën instalimi në qytetin e Gjirokastrës i 5 stacioneve transmetues për ripërsëritjen e 5 programeve te huaja (greke), pa ndërmarrë asnjë veprim administrativ për legalizimin e këtyre stacioneve sipas proçedurave të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, konkretisht të Ligjit nr. 8410, datë 30/09/1998 " Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (nenet 128 -135), si dhe Rregullores së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit " Për liçensimin e

operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës", ku, ndërmjet të tjerash, është theksuar qartë që "..*Instalimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve përsëritëse bëhet vetëm pasi është dhënë liçensa përkatëse nga KKRT-ja...Liçensa për transmetime radiotelevizive me përsëritës jepet pasi të plotësohen këto kushte...... KKRT-ja cakton numrin e përsëritësve për transmetime radiotelevizive që lejohen të funksionojnë për cdo zonë të territorit të Republikes së Shqipërisë......*

Me të konstatuar shkeljen, KKRT me vendosmëri mori masa për sjelljen e gjëndjes brënda kuadrit ligjor, duke demostruar vullnetin e mirë për gjetjen e një zgjidhjeje në përputhje me këtë kuadër.
Në mungesë të përcaktimit të saktë të frekuencave të lira, KKRT e kishte të vështirë liçensimin e subjekteve te reja. Megjithatë, për vetë karakterin e veçantë të problemit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit u tregua i gatshëm dhe i hapur për të përcaktuar një zgjidhje të pranueshme për informimin dhe argëtimin e minoritetit Grek edhe me programe në gjuhën e tij amtare.
Zgjidhje, u përcaktua bazuar në kuadrin ligjor, që parashikonte aplikimin, shqyrtimin dhe liçensimin e transmetimeve dhe rregullimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me parimet e barazisë, jodiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme.

*v. <u>Operatorët satelitorë</u>*

Transmetimet private satelitore të liçencuara nga KKRT kanë filluar në vitin 2003 me futjen në funksionim të operatorit të parë shqiptar të transmetimeve me satelit ALSAT

Me stabilizimin e transmetimeve satelitore, filluan pretendimet e operatorit satelitor për të ndërtuar një rrjet transmetimi analog tokësor për të mbuluar pjesë të konsiderueshme të territorit shqiptar, pa kaluar në proçedurën e liçensimit si operator i transmetimeve analoge tokësore e cila parashikon konkurrimin e kandidaturave.

Një praktikë e tillë, që cënon konkurrencën e ndershme, nuk ishte e parashikuar nga ligji shqiptar "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë. Pavarësisht nga mungesa e referencave të një praktike të tillë, me arsyetimin se përdoruesi shqiptar akoma nuk i përballon shpenzimet për të siguruar marrësin satelitor, në muajin Korrik me anë të ligjit ligjit nr. 9124, datë 29.07.2003 "Për disa shtesa në ligjin nr. 8410, datë 3.09.1998 për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", u realizua amendimi i mëposhtëm, i cili përcakton (Neni 136/1):

*"Operatorët radiotelevizive të licencuar nga KKRT-ja për përhapjen e programeve radiotelevizive në rrjet tokësor kanë të drejtë të ritransmetojnë programet e*

*tyre edhe në rrjetin satelitor. Operatorët radiotelevizive të liçencuar nga KKRT-ja për përhapjen e programeve radiotelevizive në satelit kanë të drejtë të ritransmetojnë programet e tyre edhe në rrugë tokësore. KKRT përcakton kushtet përkatëse në përputhje me këtë ligj".*

Ndërsa ritransmetimi i programeve tokësore me satelit është një dukuri e zakonshme edhe në vende të tjera, praktika ka vërtetuar se detyrimi i përcaktuar nga neni i mësipërm për të liçensuar transmetimet tokësore pa konkurrim kandidaturash, e vendos operatorin satelitor në pozita të favorizuara kundrejt operatorëve të tjerë që transmetojnë në rruge tokësore.

Për shkak të spektrit të kufizuar të frekuencave të destinuara për transmetime tokësore, në të gjitha rastet dhe praktikat e studiuara nga KKRT, përfshirë praktikat më të avancuara europiane, liçensat për ndërtimin e rrjetit jepen kundrejt konkurrimit të kandidaturave. Në këtë rast, për shkak të inkoherencës së ligjit, KKRT është e detyruar të përdorë dy standarde për liçensimin e shërbimit të transmetimeve analoge tokësore:

a. Për operatorët e mirëfilltë analogë tokësorë dhe
b. për përsëritësat e programeve satelitore[11].

Në kuadrin e rishikimit të ligjit "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë, KKRT parashikon të propozojë amendimin e nenit të përmendur më sipër në favor të nxitjes së konkurrencës së ndershme.

Siç është bërë e ditur kohët e fundit kanë dalë në transmetim satelitor pa lejen e KKRT edhe TV SAT+ dhe DIGITALB etj.

KKRT ka dështuar në liçensimin e tyre për shkak të pengesave ligjore, tashmë të identifikuara, lidhur me pronësinë mbi rrjetet (operatorët satelitorë nga ligji konsiderohen si operatorë kombëtarë) dhe implikimet që sjell teknologjia e re numerike.

Ndërkaq, siç duket si pasojë e konkurrencës së ashpër në tregun tashmë të ngritur, gjatë vitit 2006 SAT+ ka mbyllur aktivitetin.

Një ndër objektivat prioritarë të punës së KKRT, për vitin në vazhdim, mbetet rregulllimi dhe liçensimi i operatorëve satelitorë që aktualisht operojnë pa liçensë.

## C. PLANI I FREKUENCAVE

### *i. Administrimi i frekuencave në Shqipëri*

[11] Në kategorinë e përsëritësave futen edhe përsëritësat e programeve të huaj.

Si vend anëtar me të drejta të plota i ITU[12] Shqipëria gëzon të drejta, por ka edhe detyrime të marrë pjesë aktive në veprimtaritë dhe proçedurat që zhvillohen për rregullimin e përdorimit efikas të radiofrekuencave, që janë pasuri kombëtare e kufizuar.
Gjatë viteve, edhe për shkak i ndryshimeve që kanë pësuar strukturat e ngarkuara me administrimin e frekuencave, pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i Shqipërise me ITU ka pësuar luhatje duke krijuar boshllëqe në regjistrimin dhe mbrojtjen e radiofrekuencave për shërbime të caktuara.
KKRT, sidomos kohët e fundit, po bën të gjitha përpjekjet për plotësimin e boshllëkut të krijuar në administrimin e frekuencave në territorin e Shqipërisë për një periudhë mbi 40 vjecare. Rezultatet e arritura në RRC06 janë pasqyrimi i një pjese të punës së programuar nga KKRT për konkretizimin e këtyre përpjekjeve.

Administrimi i frekuencave në kompetencë të KKRT bëhet në bazë të marreveshjeve GE06 dhe GE06-Rev-ST61, për transmetimet televizive analoge dhe numerike, GE84 për transmetimet radio në VHF/FM për bandat 87.5-108 MHz, etj.

Por në ligjin "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", mungojnë referencat e sakta për të gjitha brezat e frekuencave dhe shërbimet përkatëse
që rregullohen nga KKRT. Ndërsa shërbimet e transmetimit radio FM (GE84) dhe televizive (ST61, GE06) janë qartësisht nën mbikqyrjen e KKRT, për shërbimet MF (GE75) që aktualisht përdoren nga RTSH, nuk ka referenca te qarta. Ligji nr.8410 (Neni 148) përcakton:
*"Të gjitha frekuencat në përdorim të RTSh-së, në castin e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten në dispozicion të këtij institucioni për një periudheë 10-vjecare".*
Ky nen zgjidh problemin e përdorimit, por nuk zgjidh atë të administrimit të tyre, ku hyn edhe koordinimi me vendet e tjera, nga të cilat, herë pas here paraqiten ankesa pranë KKRT. Aktualisht interesimi nga sektori privat për përdorimin e këtyre brezave është i ulët, por nën dritën e zhvillimeve të reja teknologjike, parashikohet rritja e kërkesës.
Duke qenë se KKRT ndodhet në fazën e rishikimit të ligjit të mediave audiovizuale, po shqyrtohet edhe mundësia e futjes së dispozitave për rregullimin edhe të këtyre bandave frekuencore.
Në punën e KKRT-së për administrimin e frekuencave për transmetime radio e televizive, vazhdon të përbëjë problem vendosja e lidhjeve të drejtpërdrejta me ITU. Forcimi i lidhjeve me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, që konsiderohet nga ITU si " pikë qendrore" ( "focal point") është një hap që do të garantojë bashkëpunimin efektiv me këtë

[12] ITU (International Telecommunications Union)- Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve

organizëm të rëndësishëm ku përcaktohen politikat globale të zhvillimit edhe të sektorit të transmetimeve radio e televizive.

### *ii. Plani i Frekuencave dhe RRC-06*

Siç është pranuar gjerësisht, një nga vështirësitë kryesore në rregullimin e fushës së transmetimeve analoge tokësore në Shqiperi ka qenë mungesa e një Plani të Caktimeve Frekuencore dhe okupimi arbitrar i spektrit.
Ndonëse KKRT ka investuar shumë në përpilimin e Hartës së Frekuencave dhe ndërtimin e një Plani Rregullimi analog paraprak, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe lëvizjet e organizmave rregullatore në nivele kombëtare dhe ndrëkombëtare për të orientuar këtë zhvillim, kanë vonuar përpunimin dhe miratimin e një plani të konsoliduar Kombëtar, të koordinuar me vendet fqinjë dhe të regjistruar nga organizma të specializuara ndërkombëtare.

Konferenca e Radiokomunikacioneve (RRC-04, Gjenevë, Maj 2004) vendosi bazat teknike për hartimin e Planit të Frekuencave Numerike të Rajonit, i cili u miratua nëpërmjet një marrëveshjeje që u nënëshkrua në Gjenevë më 16 Qershor 2006 nga përfaqësuesit e vendeve anëtare të zonës së planifikimit, pjesëmarrës në Konferencën Rajonale të Radiokomunikacioneve (RRC-06) .

Plani i ri është një kombinim i planit analog ekzistues me planin e ri numerik, që do të bashkëjetojnë deri në fund të periudhës së tranzicionit, e cila përfundon më 2015 (GE06). Vendet e CEPT (Konferenca Europiane e Postave dhe Telekomunikacioneve, ku bën pjesë edhe Shqipëria) kanë vendosur që kjo periudhë të përfundojë më 2012. Me përfundimin e kësaj periudhe, që i korrespondon mbylljes së transmetimeve analoge, plani i ri do të jetë plan krejtësisht numerik. Marrëveshja GE06, e nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Shqipërisë, po ndjek proçedurën e ratifikimit nga Kuvëndi.

## *ii. Plani i Frekuencave Numerike të Shqipërisë i miratuar nga GE06*

Plani i Frekuencave Numerike të Shqipërisë u përcaktua përfundimisht pas zhvillimit të 4 përpunimeve (iteracioneve) që do të paraqiten me hollësi më poshtë.

Karakteristikat kryesore janë:

| | |
|---|---|
| 1.Tipi i Rrjetit (për allotment): | SFN |
| 2. Varianti i Sistemit: | C2 |
| 3. Rrjeti Referencë: | RN2 |
| 4. Tipi i marrjes: | mobile |
| 5. Rasti për DVB-T në Bandën III: | 7 MHz |

**Forma e Allotmenteve[13]:**

**1. Për DVB-T në UHF:** **2. Për DVB-T në VHF** **3. Për T-DAB në VHF**



**11 Allotmente** **8 Allotmente** **2 Allotmente**

[13] Allotment: Zona që mbulon një rrjet transmetimi me disa transmetuesa. Në rastin kur nr i transmetuesave është 1, allotmenti është zona që mbulohet nga një Caktim frekuencor (assignement)

## 4. Sub-allotmenti i Tiranës për DVB-T dhe T-DAB



**Kanalet e caktuara për Shqipërinë në Planin e Frekuencave Numerike GE06**
**DVB-T në brezat VHF dhe UHF**

| Numri i Rrjeteve Shtresave | Allotmenti Shkoder | Allotmenti Kukes | Allotmenti Diber | Allotmenti Lezhe | Allotmenti Tirane | Allotmenti Elbasan | AllotmentiFier | Allotmenti Berat | Allotmenti Korce | Allotmenti Gjirokaster | Allotmenti Vlore | Sub Allotmenti Tirane |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 9 | 9 | 8 | 9 | 10 | 7 | 10 | 5 | 6 | 8 | 8 | 6 |
| 2 | 22 | 26 | 24 | 23 | 21 | 23 | 22 | 24 | 21 | 26 | 23 | 26 |
| 3 | 28 | 32 | 25 | 29 | 34 | 33 | 27 | 25 | 27 | 29 | 39 | 37 |
| 4 | 34 | 36 | 30 | 33 | 39 | 40 | 28 | 30 | 28 | 35 | 43 | 44 |
| 5 | 41 | 40 | 38 | 43 | 41 | 42 | 29 | 32 | 43 | 37 | 46 | 50 |
| 6 | 45 | 42 | 54 | 46 | 53 | 46 | 31 | 36 | 45 | 38 | 57 | 60 |
| 7 | 51 | 50 | 55 | 66 | 57 | 48 | 35 | 47 | 51 | 44 | 64 | 64 |
| 8 | 59 | 52 | 60 | 68 | 59 | 49 | 45 | 52 | 55 | 48 | 68 | 67 |
| 9 | | 56 | 63 | | 61 | 56 | 51 | 54 | 57 | 50 | | |
| 10 | | 65 | 69 | | | 58 | | 61 | 59 | 53 | | |
| 11 | | | | | | 62 | | 65 | 64 | 56 | | |
| 12 | | | | | | 68 | | 66 | | 58 | | |
| 13 | | | | | | | | | | 60 | | |
| 14 | | | | | | | | | | 63 | | |
| 15 | | | | | | | | | | 67 | | |
| 16 | | | | | | | | | | 69 | | |

**Blloqet e frekuencave të caktuara për Shqipërinë në Planin e Frekuencave Numerike GE06**
**T-DAB në brezin VHF**

| Numri i Mbulimeve | Allotmenti 01 (Veri) | Allotmenti 02 (Jug) | Sub allotmenti i Tiranes (03) |
|---|---|---|---|
| 1 | 11 D | 11 B | 11 A |




**Integrimi i allotmenteve të Planit numerik të Shqipërisë në Planin numerik të rajonit të Adriatikut e Ballkanit(Plani GE06)**




**Integrimi i allotmenteve të Planit numerik të Shqipërisë në Planin numerik të rajonit të Adriatikut e Ballkanit(Plani GE06)**

## *Zhvillimi i sesionit të II të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve (RRC-06),*

Më 15 maj 2006 u hap në Gjenevë Sesioni II i Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve, me objekt planifikimin e shërbimeve të transmetimit numerik tokësor në pjesë të Rajoneve 1 dhe 3, në brezat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz. Një konferencë e ngjashme është mbajtur edhe në Stokholm, më 1961, ku është përcaktuar dhe koordinuar midis shteteve përdorimi i frekuencave analoge tokësore televizive. Shqipëria nuk ka marrë pjesë në atë Konferencë dhe as i ka nënshkruar më pas vendimet e saj.

Në konferencën e Maj-Qershorit 2006 u bë finalizimi i punës teknike e rregullatore, për planifikimin e përdorimit të frekuencave numerike në zonën e planifikimit, ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Para fillimit të sesionit të dytë ITU, paraprakisht, u shpërndau administratave të çdo vendi pjesëmarrës Projektin e marrëveshjes për t'u miratuar në parim nga secila qeveri. Nga ana e KKRT ky dokument i u përcoll për mendime, institucioneve qëndrore dhe organeve të interesuara dhe së fundi përkthimi zyrtar, i shoqëruar nga verejtjet i institucioneve kompetente (Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit) u depozitua në Ministrine Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për të vazhduar praktikën e miratimit në parim dhe akreditimit të delegacionit nga qeveria. Përveç delegacionit të akredituar nga qeveria dhe pjesmarrësve të KKRT, konferencën e ndoqi me kohë të plotë dhe një specialist i ERT.

Gjatë punës përgatitore (përpara fillimit të Konferencës) Projekt plani i Frekuencave Numerike Shqiptare u koordinua paraprakisht me të gjitha vendet që u përfshinë në Grupin e Ballkanit (Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Mali i Zi, Turqia) dhe në Grupin e Adriatikut (Shqipëria, Austria, Kroacia, Italia, Sllovenia, San Marino, Serbia dhe Mali i Zi).

Për grupin e Ballkanit, paraprakisht u nënshkrua një marrëveshje në nivel specialitësh dhe është ndërtuar një plan allotimesh i koordinuar për DVB-T (VHF e UHF) dhe T-DAB. Grupi i Adriatikut përgatiti një marrëveshje të shoqëruar me një plan frekuencash. Marrëveshja u nënshkrua nga të gjithë anëtarët e grupit, me përjashtim të Administratës së Italisë.

Organizimi i sesionit të dytë të Konferencës u bë në funksion të prodhimit të një plani të koordinuar dhe të pranuar nga të gjithë pjesëmarrësit. Për dhënien e

formës përfundimtare të planit u organizuan katër përpunime (iteracione) të informacionit të dhënë nga të gjithë vendet pjesëmarrëse.

Radha e punës ishte:

1. Nga administratat jepeshin zyrtarisht (në formë elektronike, duke përdorur secili shtet një fjalë kalimi (password) të vecantë) të dhënat për allotmentet/caktimet frekuencorë të koordinuara sipas grupeve;
2. Të dhënat përpunoheshin nga PXT (project exercise team) i caktuar nga ITU dhe rezultatet shpalleshin në sitin e ITU;
3. Të dhënat e shpallura analizoheshin nga të gjitha vendet dhe në varësi te rezultatit organizohej negocimi bilateral dhe multilateral për të përmirësuar rezultatin;
4. Në bazë të rezultateve të negociatave, përgatiteshin Deklaratat Administrative reciproke ku nga secila administratë deklarohej se allotmentet/caktimet e tij nuk prekeshin nga allotmentet/caktimet e administratës korresponduese;
5. Deklaratat Administrative ngarkoheshin në sistem nga secila administratë (duke përdorur fjalë kalimin e vet).
6. Të dhënat përpunoheshin nga PXT dhe shpallej rezultati

Pas pikës 6 fillonte proçedura e përpunimit (iteracionit) pasardhës.

Proçedura e mësipërme u përsërit 4 herë.[14]

### *iii. Plani shqiptar i transmetimeve numerike tokësore*

Vështirësitë për të siguruar miratimin e planit shqiptar të transmetimeve numerike, ishin më të mëdha në krahasim me vëndet e tjera pjesmarrëse pasi:

- Shqipëria nuk ka nënshkruar marrëveshjen e Stokholmit 1961 për planifikimin e transmetimeve analoge dhe gjatë viteve të mëvonshme ka regjistruar vetëm 4 caktime frekuencore në MIFR (Regjistri Kryesor Ndërkombetar i Frekuencave). Regjistrimi i frekuencave do ta mbronte përdorimin e tyre në Shqipëri kundrejt pretendimit të fqinjëve. Vendet e tjera u paraqiten me shifra të larta caktimesh frekuencore të regjistruara, duke ngushtuar hapësirën dhe duke reduktuar mundësinë e manovrimit për të regjistruar frekuenca për territorin shqiptar. Kjo vështirësoi diskutimet e negocimet me vendet e tjera jo vetëm për krijimin e gjëndjes referencë, (gjendja ekzistuese e transmetimeve analoge) por edhe për të krijuar kushte për implementimin e planit të ri numerik. Për secilin rrjet numerik që do të kërkohet të vihet në punë, duhet të merret miratimi i vendeve fqinjë që duhet të shprehen se stacioni i ri numerik nuk krijon interferenca për stacionet e tyre analoge në funksionim.
- Territori i kufizuar i Shqipërisë është një vështirësi më shumë për koordinimin dhe planifikimin.

[14] Hollësi mbi zhvillimin e secilit përpunim jepen në aneks

- Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, i ndodhur midis dy grupime vendesh me kritere të ndryshme planifikimi (Grupi i Adriatikut dhe Grupi i Ballkanit) ndërlikoi më tepër arritjen e marrëveshjeve përkatëse.
- Sasia relativisht e vogël e kërkesave shqiptare, e diktuar nga dimensionet modeste të vendit, në krahasim me numrin e lartë të kërkesave të vendeve fqinjë, për mënyrën e organizimit të software-it llogaritës, diktoi si rrugëzgjidhje më të mirë marrjen e të gjitha Deklaratave Administrative të ndërsjellta midis vendeve gjë e cila çoi në rezultatin përfundimtar pozitiv.

Produkti i konferencës, plani i shërbimit të transmetimeve numerike tokësore, në pjesë të Rajoneve 1 dhe 3, në brezat frekuencore 174-230 MHz dhe 470-862 MHz, përbëhet nga tërësia e planeve kombëtare të vendeve brenda zonës së planifikimit, të koordinuara midis tyre me mekanizma teknikë e rregullatorë.

Kriteri bazë ku u mbështet planifikimi ishte sigurimi i aksesit të barabartë të të gjitha vendeve në shfrytëzimin e rezervave të kufizuara të valëve elektromagnetike. Me vendimet e marra gjatë periudhës intersesionale (midis sesionit të RRC-04 dhe RRC-06), u përcaktuan objektivat për të siguruar akses të barabartë për secilin vend pjesëmarrës

Këto objektiva ishin:

- 4 deri në 7 mbulime kombëtare me DVB-T (Televizion numerik tokesor) në brezin UHF
- 1 mbulim kombëtar me DVB-T në brezin VHF
- 2 deri në 3 mbulime kombëtare me T-DAB (radio numerike) po në brezin VHF

Delegacioni shqiptar, arriti të sigurojë plotësimin e kërkesave shqiptare në masën 100 %. Në këtë mënyrë plani shqiptar i integruar në planin e transmetimeve numerike të zonës së planifikimit parashikon:

- 7 mbulime kombëtare me DVB-T (Televizion numerik tokësor) në brezin UHF
- 1 mbulim kombëtar me DVB-T në brezin VHF
- 2 mbulime kombëtare me T-DAB (radio numerike) po në brezin VHF

Mbulimet e mësipërme janë në numër të barabartë me ato të vendeve fqinjë të Ballkanit (MKD, SCG, GRC[15])

Përveç mbulimeve kombëtare, plani parashikon edhe mbulime lokale:

- U krijua suballotmenti i Tiranës me 7 mbulime lokale DVB-T në UHF, 1 mbulim në DVB-T VHF dhe 2 mbulime në T-DAB VHF.

[15] Emërtimet sipas ITU të Maqedonisë, Greqisë dhe Serbisë e Malit të Zi

- Eshte planifikuar një numër frekuencash për mbulime lokale në të gjithë territorin e Shqipërisë
- Ekziston mundësia për identifikimin e frekuencave të tjera për shfrytëzim lokal, që mund të futen në plan në të ardhmen.

*Marrëveshjet*

Marrëveshja RRC 06 përcakton planin e proçedurat që duhen ndjekur nga administratat për vënien e planit numerik në funksionim, proçedurat për ndryshimin e planit, kohën e tranzicionit, afatin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Marrëveshja për revizionimin e Marrëveshjes së ST 61 përcaktoi masat për përshtatjën e Marrëveshjes së vjetër ST 61 me marrëveshjen e re RRC-06.

Po kështu, marrëveshja për revizionimin e Marrëveshjes së GE 89 (për vendet e Afrikës) përcaktoi masat për përshtatjen e Marrëveshjes së vjetër GE 89 me marrëveshjen e re RRC-06.

Marrëveshja RRC-06 hyn në fuqi ditën e 17 Qershorit 2007[16]. Dispozitat e Marrëveshjes do të aplikohen provizorisht duke filluar nga 17 Qershori 2006.

Nga dita e hyrjes në fuqi të marrëveshjes, stacionet transmetues me caktime frekuencore që nuk përfshihen në plan, mund të vazhdojnë operimin me kusht që të mos shkaktojnë interferencë të papranueshme për stacionet me caktimet frekuencore konform planit.

**Marrëveshja RRC-06 përcaktoi si datë të përfundimit të periudhës së tranzicionit ditën e 17 Qershorit 2015.** Për disa shtete që e kërkuan një gjë të tillë[17], periudha e tranzicionit vetëm për brezin VHF do të përfundojë ditën e 17 Qershorit 2020.
Ndërkohë vendet e CEPT-it (Konferenca Europiane e Postave dhe Telekomunikacioneve), ku bën pjesë dhe Shqipëria kanë vendosur që periudha e tranzicionit në vendet e tyre të përfundojë në vitin 2012.

*Nënëshkrimi i Marrëveshjeve*

Nga delegacioni shqiptar u nënshkruan Marrëveshja RRC-06 dhe Marrëveshja për Revizionimin e ST 61. Nënshkrimi u krye nga z. Hydajet Kopani, Kryetar i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe, (sipas dokumentit të Akreditimit), Kryetar i Delegacionit shqiptar.

[16] Neni 12 i Marrëveshjes RRC-06
[17] Algjeri, Burkina Faso, Kamerun, Kongo, Bregu i Fildishtë, Egjypt, Gabon, Gana, Iran, Jordani, Mali, Marok, Mauritani, Nigeri, Siri, Sudan, Cad, Togo, Tunizi dhe Jemen

## *D. PROGRAMACIONI*

Radiotelevizioni në përgjithësi dhe televizioni në veçanti, vlerësohen si media që ka aktualisht ndikimin më të madh në formimin e opinionit, pavarësisht nga zhvillimet dhe teknologjitë e reja të komunikimit.

Parimi themelor i zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive është se kjo veprimtari është e lirë dhe respekton paanshmërisht të drejtën për informim dhe pluralizmin e informacionit. Si transmetuesi publik ashtu edhe ata privatë janë të detyruar të respektojnë bindjet politike dhe besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut si dhe të drejtat themelore të tij. Në veprimtarinë radiotelevizive mbrohen dhe respektohen në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale dhe ligjore të të miturve dhe adoleshentëve. Veprimtaria radiotelevizive duhet të jetë në përputhje me rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.

Këto parime themelore përcaktohen në ligjin për median elektronike, pikërisht pasi dihet roli i fuqishëm që ka radio dhe televizioni në formimin e opinionit publik. Bazuar në ligj, është KKRT-ja institucioni që mbikqyr dhe monitoron respektimin këtyre parimeve nga të gjithë operatorët radiotelevizivë. Pavarësisht monitorimit dhe mbikqyrjes së autoritetit rregullator, duhet të theksojmë që në fushën e përmbajtjes, pra të respektimit të kërkesave ligjore në aspektin programor, KKRT i ka kushtuar rëndësi të veçantë vetërregullimit, duke përdorur dialogun me operatorët radiotelevizivë, bashkëpunimin me ta, duke shmangur në maksimum rrugën e sanksioneve ndaj operatorëve.

Një detyrë e rendësishmë e KKRT-së gjatë vitit 2006, ka qënë edhe respektimi i të drejtave të transmetimit dhe të drejtavë të autorit në programet e transmetuara, si një aspekt i rendësishëm i garantimit të konkurencës së ndershme në fushën e medias elektronike.

### *i. Të drejtat e transmetimit në RTV dhe të drejtat e autorit*

Gjatë vitit 2006, u intensifikuan përpjekjet në zbatim të ligjit nr. 9124, dt. 29.07.2003, për minimizimin e piraterisë radiotelevizive dhe në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të". Tashmë është i qartë dallimi midis të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit. E drejta e transmetimit për një radio dhe television është një e drejtë

ekonomike, është nje pronë dhe si e tillë shitet, blihet e mbrohet me ligj. Duke blerë një program, ç'do operator radioteleviziv detyrohet të paguajë edhe të drejtën e autorit. Pikërisht kur fillon të paguhet e drejta e autorit, nis të luftohet pirateria në transmetimet radiotelevizive. Shkalla e respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të transmetimit nuk matet me fjalime, seminare, deklarata mediatike apo raporte e relacione. Ajo sot në botë vleresohet nga masa e pagesës nepërmjet bankave, për shoqëritë e mbrojtjes së autorëve dhe distributorëve të pronësisë intelektuale. Miratimi në Prill 2005 i Ligjit "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" ishte një garanci më e madhe për të materializuar edhe përpjekjet e KKRT-së në luftën kundër piraterisë. Por dalja e ligjit duhet të shoqërohej me krijimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, që është institucioni qëndror për të ushtruar veprimtari, në mbështetje dhe në zbatim të ligjit shqiptar për të drejtën e autorit. Megjithëse kanë kaluar 22 muaj nga miratimi i ligjit , nuk është krijuar ende Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe pas saj edhe Agjencitë e Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorit. Nëpërmjet kësaj Zyre qëndrore dhe këtyre agjencive duhet që operatorët radiotelevizivë, e të gjithë përdoruesit e pronësisë intelektuale, të paguajne për përdorimin e veprave të autorëve të ndryshëm, pasi keto pagesa janë barometri që tregon shkallën e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të transmetimit. E theksojmë këtë fakt, pasi vetëm bashkëpunimi midis institucioneve si KKRT, ZSHDA, Agjensitë e Autorëve, Ministria e Financave, Gjykata, Prokuroria, Doganat do të krijojnë frontin unik për respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të transmetimit jo vetëm në fushën e medias elektronike, por në të gjitha hapsirat e përdorimit, shfrytëzimit, tjetërsimit të veprave artistike, letrare, shkencore, pra të veprimtarisë krijuese. KKRT deri tani ka qënë e vetme në këtë betejë të vështirë.

Duke luftuar fenomenin e piraterisë, indirekt mbrohen edhe autorët. KKRT, mbështetur në ligj ka të depozituara kontratat që kanë nënshkruar operatorët radiotelevizivë, e që kryesisht kanë të bëjnë më të drejtën e transmetimit të filmave artistikë, evenimenteve sportive, filmave dokumentarë, telenovelave etj. Është krijuar një "database" me të gjitha të dhënat e kontratave të lidhura nga operatorët rtv me distributorë të ndryshëm, duke bërë të mundur krahasimin e të dhënave dhe ndjekjen e zbatimit të kushteve të kontratave. Nga ky proçes janë identifikuar raste edhe të distributorëve "piratë", kontrata të dyshimta të lidhura me subjekte "fantazmë", për të cilat është reaguar me sanksione nga paralajmërim e deri në gjobë. Rezultatet janë të dallueshme. Tashmë nga të gjithë operatorët televizivë qëndrorë janë eliminuar transmetimet e paligjshme.

Deri në fund të Dhjetorit 2006 në KKRT janë depozituar kontratat për të drejtën e transmetimit të 3955 filmave artistikë dhe televizivë, për 800 dokumentarë, rreth 60 telenovela dhe 170 kontrata për transmetim ndeshjesh apo veprimtari sportive.

Pjesa e kontratave të filmave artistikë dhe televizivë përbën rreth 70% të të gjithë numrit të kontratave të depozituara. Distributorët më të fuqishëm në tregun shqiptar të medias elektronike janë Albvizion, DARO-Film Distribution, Discovery Comuniccation, RAI Trade, Powercorp UK Limited, Buena Vista International, First Look International etj.

Pirateria egziston ende në programet e transmetuara nga subjektet që operojnë në periferi, e që janë larg mbikqyrjes dhe monitorimit të KKRT-së. Ndjekja e funksionimit të tyre, nëpërmjet monitorimeve me sondazhe, të paktën dy herë në vit, shfrytëzimi i sinjalizimeve të ndryshme me prova të depozituara në KKRT, vendosja e sanksioneve ndaj piratëve televizivë, bërja publike e vendimeve të marra ndaj subjekteve piratë, ka ndikuar në minimizimin e këtij fenomeni, por jo në zhdukjen e tij. KKRT-ja me nismën e saj, apo pas ankimit të operatorëve të tjerë, vendos sanksione në rastet e transmetimit të programeve që nuk janë prodhuar nga vetë operatorët dhe për të cilët nuk kanë marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi apo dhurimi. Përsëritja e shkeljeve, e detyron KKRT-në, të reduktojë e më pas të heqë liçensën e operatorëve të liçensuar prej saj. Mjedisi radio televiziv shqiptar gjithmonë e më shumë po pastrohet nga pirateria. Janë me dhjetra kontrata që vërtetojnë blerjet e programeve nga operatorët radio televizivë shqiptar, tashmë me shuma të konsiderueshme dhe të krahasueshme me vëndet me përvojë më të madhe në fushën radiotelevizive. Janë kontrata serioze për blerje të shumta sportive ndërkombëtare, krijimtarisë kinematografike botërore, telenovelave, dokumentarëve etj. nga shumë prej operatorëvë që funksionojnë në Shqipëri.

Paralelisht me blerjen e të drejtave të transmetimit nga përdorues të ndryshëm rtv, duhen mbrojtur edhe të drejtat e autorit, një kërkesë ligjore e përcaktuar në nenin 3 të ligjit "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH". Për rregullimin këtyre marrdhënieve duhet riparë ligji, ku është e domosdoshme të parashikohet kontrata operatorëve radiotelevizivë me shoqatat për mbrojtjen e autorëve. Autorët janë të pafund, por të drejtat e tyre mbrohen nga shoqatat e krijuara dhe që funksionojne në të gjithë botën. Asnjë përdorues i krijimtarisë artistike nuk "bredh" prapa autorëve për të paguar pjesën që i takon sipas ligjit. Këtë funksion e kryejnë shoqatat e mbrojtjes së autorëve.

*Operatorët televizivë kabllorë*

E vlerësojmë të nevojshme të trajtojmë veçantë funksionimin e operatorëve kabllorë, pasi ka qënë problem funksionimi i tyre, në konkurencë me operatorët tokësorë të liçensuar dhe ata numerikë me veprimtari ende të parregulluar me ligj.

Veprimtaria e operatorëve kabllorë rregullohet nëpëmjet kërkesave të kreut IX të Ligjit Nr. 8410 dt 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH", kapitull i cili duhet riformualuar e riparë me kujdes, pasi nuk pasqyron kërkesat që rregullojne veprimtarine e këtyre subjekteve. Liçensimi i operatorëve kabllorë është proçedurë më e thjeshtë në krahasim me liçensimin e operatorëve tokësor, pasi ata nuk përdorin frekuencat, nje pasuri e limituar dhe e administruar nga KKRT. Në disa vende të Europës televizionet kabllorë nuk pajisen me liçensë nga autoritetet rregullatore. Operatori kabllor është i detyruar vetëm të paraqesë listën e kanaleve që kërkon të ritrasmetojë, sëbashku me lejen për transmetimin e tyre. Televizionet kabllorë bejnë ritransmetimin e sinjalit të operatorëve radiotelevizivë satelitorë ose tokësorë, gjithmonë duke përfshirë transmetues publikë, nëpërmjet një rrjeti shpërndarës kabllor. Liçensa për operatorët kabllorë jepet për një afat prej 6 vjetësh. Leja për vënien në punë të rrjetit kabllor për ritransmetime radiotelevizive jepet nga ERT ( Enti Rregullator i Telekomunikacionit) pas liçensimit nga KKRT. Funksionimi i operatorëve kabllorë, që ritransmetojnë programe është një dukuri e përhapur në Europë, e sidomos në Europën Juglindore. Për vendosjen e rregullave të përbashkëta për të gjitha vendet në lidhje me Copyright-in dhe të drejtat e transmetimit, është miratuar **Direktiva 93/83/** e Këshillit të Europës , dt 27.09.1993, e që aplikohet për transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllore, pra shumë vite më parë se sa në Shqipëri të lindnin televizionet e para. Aktualisht nga KKRT janë liçensuar 42 televizione kabllore, që operojnë në qendrat më të mëdha të banuara, duke përfshirë të gjitha qytet e mëdha, qytete të vogla dhe fshatra me popullsi të konsiderueshme. KKRT nuk ka liçensuar asnjë radio që ofron shërbim me kabëll, për arsyen e vetme se nuk jane paraqitur kërkesa të tilla. Aktualisht, funksionojnë edhe televizione kabllore pa leje nga KKRT në qytete dhe zona urbane me popullësi të vogël. Të ardhurat e KKRT-së, të siguruara nga pagesat vjetore të operatorëve kabllorë, përbëjnë 30% të të ardhurave nga pagesat vjetore, të gjithë raditelevizioneve të liçensuar. Në disa vende të Europës, një pjesë e këtyre të ardhurave i kalojnë pushtetit lokal , pra për bashkinë apo komunën ku operon subjekti kabllor. Për arsye të shpjegueshme që kanë të bëjnë me "fitimin e garantuar", operatorët kabllorë janë subjekte të rregullta në shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj institucionit të KKRT-së.

*Operatorët kabllorë dhe të drejtat e transmetimit*

Deri para tre vjetësh asnjë nga operatorët kabllorë nuk paguanin për sigurimin e të drejtës së ritransmetimit të programeve që ofronin. Përpara alternativës, ose të mbyllen ose të rregullohet veprimtaria e tyre, duke vlerësuar edhe kontratat që ata kanë me abonentët, u punua për të ligjëruar sa më shumë të jetë e mundur funksionimin e tyre në drejtim të sigurimit të të drejtave për ritransmetimin e programeve. Problemi u bë tepër i ndjeshëm kur u intensifikua në përgjithësi lufta kundër piraterisë në median elektronike. Transmetuesit tokësor të

fuqishëm filluan të blejnë të drejtat e transmetimit të evenimenteve të rëndësishme sportive, duke shpenzuar shuma të konsideruesheme. Eshtë fjala për ngjarjet më të mëdha sportive si Kampionatet Botërore dhe Europiane të Futbollit, Formula UNO, Kupa e Kampioneve të Europës në futboll, ndeshjet e Kampionateve më të bukura të Europës si ai italian, gjerman, francez, anglez, spanjoll etj. Duke qenë jashtë sistemit të monitorimit, dhe të verifikueshëm me vështirësi, disiplinimi i veprimtarisë së operatorëve kabllorë, ka qenë problematik në të shumtën e rasteve. Me daljen e teknologjive të reja të transmetimit digital dhe satelitor, përgjegjësia e KKRT-së u bë edhe më e madhe, pasi operatoret kabllorë nuk e vlerësonin "shkelje", piraterinë që ata kryenin, pasi vetë ishin të licensuar ndërsa platformat, të drejtat e të cilëve KKRT përpiqej të mbronte, ishin ende pa licensë. Monitorimi i operatorëve kabllorë është bërë me sondazhe, me grupe kontrolli të befasishëm në orët "pik" kur transmetoheshin evenimente të rëndësishme, të drejtat e të cilave ishin siguruar nga operatorë të tjerë në Shqipëri. Vetëm gjatë vitit 2006 kemi arritur të sjellim sadopak situatën në normalitet në qytetet më të mëdha si Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Korcë, Berat e ndonjë tjetër. Normaliteti presupozon respektimin e të drejtave të transmetimit të operatorëve të tjerë, por në asnjë rast nuk kemi arritur që të 20 apo 30 sinjalet që ata ritransmetojnë të jenë me kontrata të rregullta, detyrim i cili është objektiv i vitit 2007. Rreth ¾ ( te verifikohet) e sanksioneve të vendosura gjatë vitit 2006 nga KKRT, janë ndaj operatorëve kabllorë, për mosrespektim të të drejtave të transmetimit. Pjesa më e madhe e operatorëve kabllorë kanë siguruar të drejtat për ritransmetimin e sinjalit të disa prej televizioneve publike më të fuqishem në Europe si RAI 1, RAI 2, RAI 3, ZDF, ARD, TVE, RTP, ERT etj. Kontrata kryesore është ajo e lidhur me EBU, AGICOA dhe Albautor. Janë nënshkruar kontratat e para të operatorëve kabllorë me Eurosport 1 dhe 2, National Geografic, Euronwes, Lagardere etj. Në kontratat e operatorëve kabllorë përfshihen gjithmonë ato të lidhura me televizionet vendore në prefekturat përkatëse ku ofrohet shërbimi si dhe me televizonet qëndrore si "Vizion +", "Alsat", "Koha", BBF, "Nwes 24" etj, duke përfshire edhe TVSH-në. Operatorët kabllorë kanë krijuar një shoqatë që funksionon rregullisht e me të cilën KKRT ka pasur lidhje të vazhdueshme në funksion të luftës kundër piraterisë. Kohët e fundit disa nga operatorët kabllorë kanë bashkëpunuar me kompani të tjera të specializuara për të vendosur rrjetin e tyre kabllor, në funksion të shërbimit internet. Kablli ofron mundësinë edhe për shërbimin e telefonisë, gjë e cila është në planet e tyre në të ardhmen. KKRT gjatë vitit 2007 ka në planin e punës rishikimin e pjesës së ligjit për funksionimin e operatorëve kabllorë, identifikimin e tyre me logon përkatëse, verifikimin e numrit të abonentëve, mbylljen e transmetimeve pa leje dhe heqjen e licensave të gjithë atyre subjekteve që nuk respektojnë të drejtat e transmetimit.

E drejta e transmetimit te kamponatit boteror të futbollit

Transmetimi i evenimentit sportiv më të rëndesishem të vitit 2006, Kampionatit Botëror të Futbollit Gjermani 2006, krijoi mjaft diskutime, që kishin të bënin me konkurencën, piraterinë, interesat e publikut etj. Kampionati Botëror i Futbollit, u transmetua në Shqipëri nëpërmjet:
Televizionit "TOP CHANNEL"

- o Platformës "DigitALB"
- o Nga të gjithë opertorët kabllorë.
- o Nga disa televizione vendore ( në mënyrë pirate)

Pyetjet që u shtruan nga publiku por edhe nga institucionet e interesuara kanë qënë:

1. Pse këtë eveniment nuk e transmetoi Televizioni Publik Shqiptar ?
2. Pse dhe si u transmetua nga operatorët kabllorë?
3. Si u transmetua nga disa operatorë në mënyrë pirate?

Në KKRT u paraqit në muajin Tetor 2005, një kontratë nga **Top Channel,** e datës 18 Janar 2005, lidhur dhe nëshkruar me poseduesin e të drejtave të transmetimit të kësaj veprimtarie që ishte shoqëria **InfrontSport&Media AG** dhe **FIFA.**
Kontrata ishte e vlefshme për këto lloje transmetimesh: **Free, Pay, Cable, Satellite,** të drejta nënlicensimi brenda territorit shqiptar. Kjo kontrate u shoqërua, pas kërkesës së KKRT-së, edhe me marreveshjen e lidhur midis Top Channel dhe DigitAlb, në datën 01.09.2005, që lejonte transmetimin me pagesë të ndeshjeve të FIFA WORLD CUP 2006, e për të cilën duhej njoftuar edhe Infront SPORT.
KKRT iu drejtua organizmit me të lartë të futbollit botëror FIFA, në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur. Pergjigjia ishte se FIFA e ka deleguar te drejtën e lidhjeve të këtyre kontratve tek Infront Sport, që konfirmonte se asnje operator tjeter veç DigitALB dhe Top Channel nuk është licensuar për të drejtën e transmetimit apo ritransmetimit të këtij evenimenti në Shqipëri.
Të 22 ndeshjet e Kupës së Botës 2006, nga 64 gjithsej, ku përfshiheshin me detyrim takimet gjysemfinale dhe finalja, ishin të detyruara te transmetoheshin **"free on air"** nga Top Channel. Ky televizion përveç 22 ndeshjeve të detyrueshme, transmetoi edhe takimet çerekfinale.
Drejtues të Infront SPORT&MEDIA kanë këkuar herë pas here informacione nga KKRT, në lidhje me përmbushjen e kushtit për transmetimin "free" te këtyre 22 ndeshjeve. Ndërkaq është paraqitur prej tyre edhe një kërkesë në lidhje me zonën e mbulimit dhe penetrimin e sinjalit, fillimisht të televizionit TOP CHANNEL, e me pas mbi zonen e mbulimit të televizioneve të tjera kombëtare, duke përfshire edhe televizionin publik. Materiali i kërkuar u dergua ë mënyrë elektronike në zyrat e Infront SPORT.

Pse kete eveniment nuk e transmetoi Televizioni Publik Shqiptar ?

Publiku, dashamiresit e sportit, KKRT, duke marrë parasysh plotësimin e kërkesave të publikut, gjëndjen ekonomike të publikut në përgjithësi, mundësinë për transmetimin "free" të të gjitha ndeshjeve, statusin e DigitALB si platformë që operonte ende pa u rregulluar veprimtaria e saj me ligj, dëshironim që këtë veprimtari sportive ta transmetonte TVSH , por :

*Së pari,* nuk ka detyrim ligjor që këtë eveniment ta transmetonte operatori publik.

*Së dyti,* procesi për blerjen e të drejtave të transmetimit të evenimenteve të mëdha sportive fillon shumë herët përpara datës së zhvillimit të këtyre veprimtarive. Fakti që kontrata me Top Channel është nënshkruar në datën 18 Janar 2005, pra 1 vit e gjysëm përpara fillimit të aktivitetit është bindës dhe vërteton çka thamë më sipër. Drejtuesit e RTSH, duke mësuar shifrat e blerjes së këtij evenimenti dhe duke i krahasuar me mundësite e tyre financiare, nuk e kanë vlerësuar këtë moment dhe mesa duket janë shmangur nga pjesëmarrja në garë. Nuk është kërkuar as ndihma e shtetit dhe nuk është vlerësuar roli i sponsorëve për të siguruar këtë blerje.

KKRT nuk ka ndërhyrë në këtë "tender", por KKRT mund të kishte ndërhyrë pranë RTSH-së, pranë Këshillit Drejtues të RTSH-së, por edhe pranë Qeverisë për të mundësuar sigurimin e të drejtës së transmetimit të Kupës së Botës. Theksojmë se në periudhën e nënshkrimit të kontratës së FIFA WORLD CUP - Gjermani 2006, po ky transmetues publik miratonte blerjen e të drejtës së transmetimit të "Kafazit të Artë" nga një television privat vendor, marrëveshje e kontestuar edhe nga KKRT-ja për një program pothuajse mediokër.

Pse dhe si u transmetua nga operatorët kabllorë?

Ndalimi transmetimit të këtij evenimenti nga ana e operatorëve kabllorëve është kërkuar me ngulm edhe nga poseduesit e të drejtës së transmetimit në territorin e Shqipërisë, pra nga Top Channel dhe DigitALB. Ka një korespondencë të gjërë midis KKRT-së, Top Channel dhe Digit Alb, Operatorëve Kabllorë, Albautor, AGICOA dhe EBU për këtë problem.

Operatorët kabllorë kanë nënshkruar kontratën me EBU, AGICOA dhe ALBAUTOR në lidhje me ritransmetimin e kanaleve publike europiane si RAI, ZDF, ARD etj. Fakti që stacionet e mësipërme e transmetonin Kupën e Botës, e kompromentonte çështjen dhe e acaronte situatën.

Në marrëveshjen e cituar më sipër theksohet se në rastin kur cënohen të drejtat e transmetimit dhe të autorit, mbajtësit e të drejtave duhet të njoftojnë operatorët kabllorë, 96 orë më përpara për të ndërprerë ritransmetimin. Në rastin tonë as Albautor, as EBU dhe as AGICOA, të përcaktuara në marrëveshje si mbajtës të të drejtave, nuk kanë njoftuar operatorët kabllorë për ndërprerjen e sinjalit të këtyre kanaleve.

KKRT u interesua pranë EBU, Bashkimit Europian të Transmetueve dhe na sqaruan se këtu nuk kemi të bëjmë me transmetim, por me ritransmetim të një

sinjali, praktikë e njohur edhe në vende të tjera të Europës Juglindore. Sipas tyre kabllorët nuk duhet t'i transmetojnë ndeshjet me komentatoret e vet, kurse ritransmetimi nuk është i ndaluar. KKRT nuk kërkoi nga operatorët kabllorë të ndërprisnin ritransmetimin e ndeshjeve, por sugjeroi tek poseduesit e këtyre të drejtave në Shqipëri t'i drejtohen gjykatës për të zgjidhur këtë problem dhe për të kompensuar dëmin e shkaktuar nëse i janë cënuar të drejtat, sipas tyre, prej transmetimit pirat nga ana e operatorëve kabllorë.
Vetë Top Channel, e rriti numrin e transmetimeve "free", duke përfshirë të gjitha takimet çerekfinale të padetyrueshme në kontratë. Ndërkaq është hapur një çështje gjyqësore midis Top Channel dhe DigitAlb nga njëra anë dhe Albautor e disa prej operatorëve kabllorë më të mëdhenj nga ana tjetër.

Si u transmetua nga disa operatorë në mënyrë pirate?

Në përgjithësi u respektua e drejta e transmetimit nga pjesa më e madhe e transmetuesve vendorë private. Bëjnë përjashtim televizionet "ANTENA NORD" në Shkodër, "APOLLON" në Fier, televizioni "6+1" në Vlorë që janë të identifikuar e për të cilët janë vendosur edhe sanksione me gjobe sipas këkesave të ligjit. Ndeshjet e Kupës së Botës u transmetuan edhe nga televizionet e qyetetit të Bajram Currit, Tv "Johaniter" i Shijakut, Tv "Dibra " në Peshkopi apo edhe në ndonjë qytet tjetër të vogël, transmetime pirate të pandëshkuara me sanksione. Po ashtu është transmetuar nga përseritësit e paligjshëm të vendosur nga Bashkitë e qyteteve të Korçës, Përmetit dhe nga një përsëritës i sinjalit të televizionit grek "NET në qytetin e Gjirokastrës.

### *ii. <u>Programet informative</u>*

Programet informative në radio dhe television edhe gjatë vitit 2006 kane qënë pjesa më e arrirë e strukturës programore të aplikuar. Si ne transmetuesin publik ashtu edhe në ato private janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të krijuar një fizionomi te caktuar duke operuar me edicionet informative dhe rubkrikat e aktualitetit.

Lajmet e operatorëve privatë me qëndër në Tiranë si "Klan", "Top Channel", "Vizion +", "Tv Alsat", Top Albania Radio, Radio "Club FM", Radio "Euro Star", janë tashmë profesionalisht të strukturuara. Nga operatorët televizivë lokalë nëpër rrethe do të veçonim Tv si, "Alpo"- Gjirokastër, "6+1" - Vlorë, "Lobi" dhe "Magic Star" në Korçë, Tv "Lezha", "Rozafa" në Shkodër etj. Radiot vendore informojnë dëgjuesit e vet gjatë gjithë ditës me programe të zakonshme lajmesh, por edhe me programe të komunikmit të hapur me publikun, ose edhe në programet edukative dhe argetuese. Radiot edhe televizionet vendore janë të detyruara me ligj, që të paktën 15% e programeve javore të përmbajnë informacion dhe programe që lidhen me realitetin lokal. Ky detyrim fillon të

zbatohet që në emisionin e mengjesit, ku veç edicioneve të zakonshme informative, buletineve të shkurtra të lajmeve që freskohen nga një edicion në tjetrin, transmetohen informacione të karakterit utilitar, radioreportazhe etj
Tashmë publiku e ka të përcaktuar qartë dhe e ndjen politikën editoriale të çdo subjekti mediatik. Publiku e vlereson edhe shkallën e varësisë së operatorëve rtv nga politika dhe biznesi. Sipas kësaj shkalle është ndarë edhe audienca në oraret e transmetimit të lajmeve dhe emisioneve politike. Në edicionet e lajmeve ka një rendje dhe konkurrencë midis operatorëve për të përcjellë me shpejtësi cfardo lloj informacioni, por asnjëherë nuk vërehet i njëjti zell dhe e njëjta konkurencë për të verifikuar këtë lloj informacioni, që është rregulli numër një i profesionalizmit në pasqyrimin e lajmeve. Duhet pranuar se lajmet ne ekranet e tv tona ashtu si edhe ne gjithë median janë të ngjashme. Kështu do të ndodh përderisa mungon gazetaria e mirefilltë investigative, kur lajmet sensacionale, të kronikës së zezë, janë pjesa më e përzgjedhur nga departamentet e informacionit, kur akuzat dhe kundërakuzat e politkanëve jepen si të vërteta absolute, të deklaruara në konferenca shtypi apo salla të posaçme të ngritura në çdo institucion politik apo edhe shtetëror.

KKRT bazuar në ligjin "Për radion dhe televizionin publik dhe privat ne RSH" ështe e detyruar monitorojë programet informative të transmetuar vetëm nga operatorët radiotelevizivë kombetarë. Në raste të veçanta, KKRT monitoron edhe programet informative te transmetuara nga operatorët radiotelevizivë vendorë.

Gjatë vitit 2006 u monitoruan nga KKRT edicionet kryesore të lajmeve të Radio Tiranës dhe Televizionit Shqiptar, televizioneve kombëtare "KLAN" e "ARBERIA", si dhe lajmet në "Top Albania Radio" e "Radio +2".

Si rregull rezultatet e monitorimit u janë bërë të njohura të gjithë operatorëve radio dhe televizivë të monitoruar,. Këto rezultate u janë paraqitur edhe partive politike parlamentare, Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë si dhe institucioneve ndërkombëtare të specializuara e atyre që vëzhgojnë median shqiptare. Raportet e monitorimit paraqesin të dhëna statistikore mbi kohën e vënë në dispozicion nga operatorët radiotelevizivë në edicionet kryesore të lajmeve, për veprimtarinë e organeve të qeverisë dhe parlamentit, për veprimtaritë e partive politike, të aktorëve të ndryshëm politikë dhe social-ekonomikë etj. Po ashtu jepen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të personaliteteve politike dhe shtetërore në ekranet televizive dhe mikrofonet e radios. Në një tabelë të veçantë jepet koha në minuta dhe përqindje, që operatorët rtv të monitoruar i kanë kushtuar pasqyrimit të veprimtarive të pozites nga njëra anë dhe opozitës nga ana tjetër. Në kohën për pozitën llogaritet koha e dhënë për Qeverinë, Kryeministrin dhe partitë parlamentare të pozitës.

**Radiotelevizioni Shqiptar.** Gjatë vitit 2006 rreth 55 përqind e kohës në edicionet kryesore të lajmeve në TVSH -së, i është kushtuar pasqyrimit të veprimtarive të pozitës, pra qeverisë, kryeministrit dhe partive parlamentare të mazhorancës, ndërsa 30% e kësaj kohe i është venë në dispozicion pasqyrimit të veprimtarive të opozitës. Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion e ka patur qeveria me 24% dhe kryeministri me 20.7%. Veprimtaritë e parlamentit kanë zënë rreth 10% të kohës së përgjithëshme të edicioneve informative.

Aktori kryesor me kohën më të madhe sinkron në TVSH, ka qenë kryeministri Sali Berisha me rreth 20 % të kohës sinkron në dispozicion të tij për t'ju drejtuar publikut nëpërmjet ekranit të TVSH-së. I dyti renditet nga monitorimi kryetari i PS-së Edi Rama me 13.5% të kohës sinkron të aplikuar nga TVSH. Rreth 56% e gjithë kohës sinkron i është dhënë aktorëve të pozitës dhe rreth 36% e kohës i është lënë aktorëvë të opozitës parlamentare.

Tema kryesore e trajtuar nga TVSH në edicionet e lajmeve ka qenë "politika" dhe "problemet sociale".

Raporte pothuajse të njëjta ka ruajtur edhe **RadioTirana** në edicionet kryesore të lajmeve, ku 49% e kohës i është vënë në dispozicion pasqyrimit të veprimtarive të pozitës dhe 28.8% pasqyrimit të veprimtarive politike të opozitës. Për institucionet, koha ne dispozicion të qeverisë ka qenë 14.2% dhe për kryeministrin 22.7%.

Aktori kryesor sinkron në Radio Tirana ka qënë kryeministri Sali Berisha,me rreth 27.5% të kohës sinkron të dhënë për të gjithë aktorët e tjerë politikë. I dyti renditet Edi Rama me 13.3% te kohës së përgjithëshme sinkron. Tema kryesore e trajtuar në lajmet e Radio Tiranës ka qënë "politika" dhe "lajmet ndërkombetare". Si në TVSH ashtu edhe në Radio Tirana, aktori i dytë sinkron me rreth 10% më pak të kohës në dispozicion për të komunikuar me publikun ka qënë kryetari i PS-së, Edi Rama. Rreth 57% e gjithë kohës sinkron i është dhënë pozitës dhe rreth 34% e kohës i është lënë aktorëvë të opozitës parlamentare.

**Televizioni kombëtar "KLAN":** Rreth 56% e kohës televizive i është kushtuar veprimtarive të qeverisë dhe pozitës parlamentare, ndërsa 32% e kohës i është kushtuar pasqyrimit të veprimtarive të opozitës parlamentare. Nga institucionet, qeveria dhe kryeministri kanë zënë pothuajse kohë të barabartë, respektivisht me 21% dhe 19% të kohës televizive.

Në TV "KLAN" personalitetet politike që i janë drejtuar publikut sinkron më shumë janë Sali Berisha me 22% të kohës së përgjithshmëe sinkron dhe Edi Rama me 11% te gjithë kohës sinkron e destinuar për aktorët politikë. Vetëm në muajin

Tetor dhe Nëntor 2006 koha sinkron për të dy liderët e forcave kryesore politike ka qënë e barabartë në Tv Klan.

Tema kryesore e trajtuar në edicionet e Tv Klan ka qenë "politika". Rreth 60% e gjithë kohës sinkron në edicionet informative i është dhënë pozitës dhe rreth 35.8% e kohës sinkron i është lënë aktorëvë të opozitës parlamentare.

**Televizioni kombëtar "ARBERIA":** Ka ruajtur një farë ekuilibri në pasqyrimin e veprimtarive të forcave politike, pavarësisht nga mangesitë e paraqitura në formën e përgatitjes dhe paraqitjes së edicioneve informative gjatë vitit 2006.

Rreth 47% e kohës në edicionet e lajmeve në TVA, i është kushtuar veprimtarive të partive të pozitës, ku qeveria dhe kryeministri zënë hapsirë të barabartë, me 16% të kohës. Rreth 41% e kohës i është dhënë veprimtarive të opozitës.

Aktorët politikë, që i janë drejtuar më shumë sinkron publikut në TVA, janë liderët e partive politike kryesore, dhe konkretisht kryeministri Sali Berisha me 16% dhe Kreu i PS-së Edi Rama me 13%.

Rreth 46.8% e gjithë kohës sinkron i është dhënë aktorëve të pozitës dhe rreth 47.7% e kohës i është lënë aktorëvë të opozitës parlamentare.

**"Top Albania Radio":** Rreth 47% e kohës në edicionet e lajmeve i është dhënë pozitës dhe 37% e kësaj kohe i kushtohet pasqyrimit të veprimtarive politike të partive opozitare parlamentare.
Aktorët sinkron me kohën më të madhe në dispozicion në TAR, mbeten liderët e partive politike, ku 15% të kësaj kohe i jepet kryeministrit dhe Kryetarit të PD-së Sali Berisha dhe 11% e kësaj kohe sinkron i lihet kryetarit të PS-së Edi Rama. Nga subjektet politike pozita zë rreth 53% të kohës së përgjithëshme sinkron dhe rreth 40% e kohës i është lënë aktorëvë të opozitës parlamentare.

Gjatë vitit 2006 janë monitoruar edhe edicionet informative të **"Radio + 2"**, e licencuar si radio kombëtare, monitorim i kryer me sondazhe e ku vërehet një përpjekje për pasqyrim të ekuilibruar.

Pothajse çdo muaj është monitoruar edhe qëndrimi i operatorëve të ndryshëm kombëtarë për të njëjtin lajm. Ky studim dhe tabelat me të dhëna statistikore përmbledhëse për të gjithë radiot dhe televizionet e monitoruara, u janë dërguar çdo operatori me qëllim që të mund të bëhen krahasimet e nevojshme dhe të nxirren konkluzione që mund të vlejnë në përmirësimin e punës në të ardhmen. Më poshtë po paraqesim tabelat kryesore përmbledhëse teë monitorimit 2006.

**RAPORTI I DEPARTAMENTIT TE PROGRAMEVE**

**PER EDICIONET INFORMATIVE**

Koha e **Plotë** për Subjektet Politike (***koha në %***)

SHKURT - NENTOR 2006

| Subjektet / OPERATOR | TVSH | TV KLAN | TVA | RADIO TIRANA | TAR |
|---|---|---|---|---|---|
| **PRESIDENTI** | 4.24% | 2.31% | 2.76% | 6.26% | 3.23% |
| **KRYEMINISTRI** | 20.71% | 21.61% | 16.21% | 22.68% | 14.48% |
| **QEVERIA** | 23.99% | 19.47% | 16.63% | 14.19% | 16.28% |
| **PARLAMENTI** | 10.02% | 8.72% | 7.40% | 15.26% | 12.09% |
| | | | | | |
| PARTIA DEMOKRATIKE (PD) | **6.55%** | **10.07%** | **7.89%** | **7.23%** | **10.34%** |
| PARTIA SOCIALISTE (PS) | **19.66%** | **21.08%** | **27.62%** | **19.70%** | **24.31%** |
| ALEANCA DEMOKRATIKE **(AD)** | 0.67% | 0.98% | 1.20% | 0.55% | 1.74% |
| LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM **(LSI)** | 6.48% | 7.01% | 9.32% | 6.08% | 7.95% |
| PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE **(PAA)** | 0.61% | 0.31% | 0.70% | 0.64% | 0.41% |
| PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT **(PBLD)** | 0.04% | 0.02% | 0.14% | 0.00% | 0.00% |
| PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT **(PBDNJ)** | 0.26% | 0.78% | 0.83% | 0.41% | 0.54% |
| PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPERISE **(PDSSH)** | 0.65% | 1.12% | 0.83% | 0.78% | 1.14% |
| PARTIA DEMOKRATE E RE **(PDR)** | 0.76% | 1.00% | 1.35% | 0.91% | 1.55% |
| PARTIA DEMOKRISTIANE **(PDK)** | 1.45% | 1.27% | 1.69% | 2.15% | 1.91% |
| PARTIA REPUBLIKANE **(PR)** | 1.12% | 2.16% | 1.50% | 0.92% | 1.66% |
| PARTIA SOCIALDEMOKRATE **(PSD)** | 1.78% | 1.89% | 2.32% | 1.69% | 1.92% |
| | | | | | |
| PARTI TE TJERA | 1.01% | 0.21% | 1.63% | 0.55% | 0.45% |
| | | | | | |
| **SHUMA** | **100.00%** | **100.00%** | **100.00%** | **100.00%** | **100.00%** |
| POZITA (KRYEMINISTRI + QEVERIA + PARTITE PARLAMENTARE) | **55.50%** | **56.68%** | **46.93%** | **49.13%** | **47.17%** |
| OPOZITA (PARTITE PARLAMENTARE) | **29.24%** | **32.07%** | **41.28%** | **28.80%** | **37.07%** |

**RAPORTI I DEPARTAMENTIT TE PROGRAMEVE**

**PER EDICIONET INFORMATIVE**

Koha **Sinkron** për Subjektet Politike (***koha në %***)

SHKURT - NENTOR 2006

| Subjektet / OPERATOR | TVSH | TV KLAN | TVA | RADIO TIRANA | TAR |
|---|---|---|---|---|---|
| PRESIDENTI | 2.28% | 1.44% | 1.66% | 3.46% | 2.04% |
| KRYEMINISTRI | 20.05% | 21.81% | 15.51% | 27.08% | 15.59% |
| QEVERIA | 21.66% | 17.08% | 14.71% | 13.64% | 17.51% |
| PARLAMENTI | 4.19% | 2.73% | 2.30% | 5.36% | 3.85% |
| | | | | | |
| PARTIA DEMOKRATIKE (PD) | **9.84%** | **13.99%** | **9.87%** | **10.27%** | **13.48%** |
| PARTIA SOCIALISTE (PS) | **24.73%** | **23.22%** | **31.97%** | **25.30%** | **27.79%** |
| ALEANCA DEMOKRATIKE (AD) | 0.83% | 1.29% | 1.48% | 0.59% | 2.26% |
| LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM (LSI) | 7.54% | 7.71% | 10.44% | 4.82% | 6.38% |
| PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA) | 0.48% | 0.27% | 0.67% | 0.74% | 0.39% |
| PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD) | 0.04% | 0.05% | 0.12% | 0.00% | 0.00% |
| PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ) | 0.30% | 0.86% | 0.89% | 0.45% | 0.67% |
| PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPERISE (PDSSH) | 0.91% | 1.46% | 1.09% | 0.86% | 1.38% |
| PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR) | 1.01% | 1.34% | 1.48% | 1.13% | 1.83% |
| PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK) | 1.73% | 1.62% | 1.90% | 2.68% | 2.36% |
| PARTIA REPUBLIKANE (PR) | 1.33% | 2.83% | 1.68% | 0.98% | 1.70% |
| PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD) | 2.12% | 2.14% | 2.72% | 2.32% | 2.28% |
| | | | | | |
| PARTI TE TJERA | 0.96% | 0.17% | 1.51% | 0.33% | 0.49% |
| | | | | | |
| SHUMA | **100.00%** | **100.00%** | **100.00%** | **100.00%** | **100.00%** |
| POZITA (KRYEMINISTRI + QEVERIA + PARTITE PARLAMENTARE) | **56.45%** | **59.85%** | **46.82%** | **56.96%** | **53.54%** |
| OPOZITA (PARTITE PARLAMENTARE) | **36.12%** | **35.82%** | **47.70%** | **33.89%** | **40.08%** |

**RAPORTI I DEPARTAMENTIT TE PROGRAMEVE**

**PER EDICIONET INFORMATIVE**

Koha **Sinkron** për Aktorët Politikë (***koha në minuta dhe %***)

SHKURT - NENTOR 2006

| Aktori Politik | TVSH | |
|---|---|---|
| | Min | % |
| Alfred Moisiu | 34.51 | 2.38% |
| Sali Berisha | 299.08 | 20.62% |
| Jozefina Topalli | 45.49 | 3.14% |
| Edi Rama | 196.29 | 13.54% |
| Aktorë të Tjerë | 874.79 | 60.32% |
| **Shuma** | **1,450.16** | **100.00%** |

| Aktori Politik | TV KLAN | |
|---|---|---|
| | Min | % |
| Alfred Moisiu | 19.27 | 1.48% |
| Sali Berisha | 285.16 | 21.95% |
| Jozefina Topalli | 25.29 | 1.95% |
| Edi Rama | 138.23 | 10.64% |
| Aktorë të Tjerë | 831.04 | 63.98% |
| **Shuma** | **1,298.99** | **100.00%** |

| Aktori Politik | TVA | |
|---|---|---|
| | Min | % |
| Alfred Moisiu | 15.15 | 1.79% |
| Sali Berisha | 135.89 | 16.07% |
| Jozefina Topalli | 9.45 | 1.12% |
| Edi Rama | 103.94 | 12.29% |
| Aktorë të Tjerë | 581.17 | 68.73% |
| **Shuma** | **845.60** | **100.00%** |

| Aktori Politik | R. TIRANA | |
|---|---|---|
| | Min | % |
| Alfred Moisiu | 22.51 | 3.47% |
| Sali Berisha | 176.53 | 27.23% |
| Jozefina Topalli | 17.38 | 2.68% |
| Edi Rama | 86.42 | 13.33% |
| Aktorë të Tjerë | 345.37 | 53.28% |
| **Shuma** | **648.21** | **100.00%** |

| Aktori Politik | TAR | |
|---|---|---|
| | Min | % |
| Alfred Moisiu | 7.38 | 2.05% |
| Sali Berisha | 57.39 | 15.95% |
| Jozefina Topalli | 6.39 | 1.78% |
| Edi Rama | 38.52 | 10.70% |
| Aktorë të Tjerë | 250.24 | 69.53% |
| **Shuma** | **359.92** | **100.00%** |

## Përsëri për edicionet informative

KKRT vëren konkurencën e madhe të operatorëve radiotelevizivë për të dominuar informacionin. Kjo dukuri është më e theksuar tek operatorët radiotelevizivë me qendër në Tiranë. Shprehje e kësaj dukurie është edhe shtimi i operatorëve televizivë që transmetojnë 24 orë lajme dhe programe të tjera informative, si News 24, Nesër Tv, Ora 24, Tv A1 etj.

Si operatorët rtv me licensë kombëtare, por edhe ata me ndikim të madh në publik, e kanë tashmë të stabilizuar gjininë e informacionit në strukturën e vet

programore. Këtu përfshihen Tv Klan, "Top Channel" "Vizion +", "Koha" por edhe operatorë të tjerë. Bën përjashtim në këtë grup televizioni kombëtar "Arbëria" i cili gjatë vitit 2006 ka paraqitur oshilacione në formën dhe hapsirën që kanë zënë programet informative, në strukturën e vet programore. Shkelje e kërkesave të ligjit Nr. 8410 dt 30.09.1998 nga operatori TVA, ishte ndërprerja e transmetimit të lajmeve, në kuadrin e një kolapsi që mbërtheu këtë operator gjatë muajve Mars dhe Prill 2006, periudhë në të cilën u ndërpre transmetimi i edicioneve të lajmeve.

Ligji "Per radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH" i detyron operatorët radiotelevizivë kombëtarë të transmetojnë çdo ditë lajme. Pas insistimit të KKRT-së, në datën 5 Prill 2006, nëpërmjet shkresës me nr. 10 prot, televizioni "Arberia" njoftonte, se *"ka ndërprerë përkohësisht transmetimin e edicioneve informative për shkak të ristrukturimit të studiove të transmetimit, rinovimit të teknologjisë dhe të përshtatjes e krijimit të skenografive, për këto edicione dhe programe të reja"*, angazhime që nuk u respektuan gjatë vitit 2006. Në muajin Maj 2006, TVA rifilloi transmetimin e edicioneve informative, me një format të ri për TVA-në, por të vjetër në përdorim në tregun mediatik, pa studio dhe dhomë lajmesh, pa folës dhe me pak gazetarë në terren. Kjo formë e përcjelljes së lajmeve vazhdoj gjatë vitit 2006 dhe sëbashku me mungesa të tjera në strukturën programore, u bën shkas e ndërmarrjes së sanksioneve për këtë operator.

Në edicionet e lajmeve të operatorëve radiotelevizivë vazhdon tendenca që lajmi i parë të jetë nga politika dhe veprimtaritë e qeverisë. Vetëm në raste të pakta vendin e parë në lajme e zënë problemet sociale. Kronika e zezë si lajm i parë, dominon në të gjitha rastet kur ndikojnë ethet e konkurencës. Në trajtimin e temës "kronika e zezë", gjithmonë e më shumë dallohet tendenca për të shmangur pamjet "makabre". Në këtë aspekt duhen dalluar më me profesionalizëm rastet kur paraqiten si lajm, të gjitha arestimet e kryera nga komisariatet dhe drejtoritë e policive, ku i ofrohen medias kaseta të gatshme filmike dhe njoftime për shtyp, nëpërmjet të cilave komisariatet kanë si qëllim të publikojnë "arritjet" e tyre.

Një dukuri tjetër e pasqyruar në edicionet informative të operatorëve radiotelevizivë, është fakti se i njëjti lajm, pasqyrohet në mënyra të ndryshme nga operatorë të ndryshëm, duke u nisur nga qëndrimi editorial i secilit operator. Edhe në pjesën sinkron të zgjedhur, vazhdon të dominojë tendenca e përzgjedhjes së ideve që u interesojnë operatorëve të caktuar dhe jo publikut.

KKRT, është rregullatori i ngarkuar me ligj për të monitoruar edicionet informative dhe veprimtaritë politike të operatorëve kombëtarë. Por është vënë re ndikimi i subjekteve të tjera të medias elektronike tek publiku, dukuri për të

cilin KKRT po punon për të shtrirë monitorimin edhe për operatorët e tjerë, me vëmendjen për të mos e shndëruar monitorimin si element të censurës.

### *iii. Etika në media*

Monitorimi i normave morale dhe etike në programet rtv, ato që kryesisht kanë të bëjnë me keqpërdorimin e dhunës, seksit dhe cënimin e dinjitetit të individit në programet e transmetuara, janë trajtuar nga Këshilli i Ankesave deri në gjysmën e vitit 2006, kohë në të cilën përfundoi edhe mandati i këtij organizmi këshillimor pranë KKRT-së, i përcaktuar i tillë nga neni 18 i Ligjit Nr 8410 dt 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH". Objekt i punës së Këshillit të Ankesave ka qenë sensibilizimi i opinionit publik, mbi respektimin nga media elektronike, të normave etiko morale në transmetimet e destinuara për publikun e gjerë.
Kontaktet me publikun dhe operatorët, me median e shkruar, si dhe me institucione të interesuara për çështjet etiko morale në ekran, vëzhgimet, sondazhet, studimet dhe përvoja e mbledhur, janë trajtuar çdo vit në buletinin "Antena", botim i Këshillit të Ankesave pranë KKRT-së.
Edhe buletini i vitit 2006 ka pasqyruar ndjeshmërinë e publikut shqiptar ndaj keqpërdorimit të dhunës së tepruar, seksit dhe dinjitetit në ekran dhe ka shërbyer për rritjen e përgjegjësisë së operatorëve radiotelevizivë në respektimin e standarteve të pranueshme etiko dhe morale në transmetimet e tyre.
Eshtë fakt se ndjeshmëria e operatorëve transmetues për të respektuar normat etike e morale ka ardhur duke u rritur. Mbeten problem programet erotike në sistemet transmetuese me pagesë, dukuri që duhet të zgjidhet së bashku me ligjin për transmetimet numerike. Situata kërkon rregullimin me ligj të transmetimit të programeve të koduara me dhunë të tepruar dhe pornografi.

Ende mbetet çështje parësore nevoja që çdo operator radioje ose televizioni të ketë një kod etike në përputhje me standartet e pranuara sot gjerësisht e që është një marrëveshje me publikun për normat etiko-morale që çdo subjekt radiotelevíziv synon të arrijë.

Statusi i Këshillit të Ankesave, si organizem këshillimor pranë KKRT-se ishte i cunguar në krahasim me problematikën që trajtonte e që duhej zgjeruar krahas me keqpërdorimin e dhunës, seksit, edhe me diskriminimin e personalitetit për shkak të gjinisë, racës, kombësisë, cënimin e privatësisë, abuzimin me gjuhën e folur, kultivimi i një fjalori të pahijshem etj. Nga organizëm këshllimor duhej trasformuar edhe si vendimarrës.

Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të KKRT-së dhe Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me Vendimin Nr. 66, datë 11.12.2006 krahas miratimit të strukturës dhe organikës së KKRT-së, miratoi edhe ngritjen e Këshillit të Etikës. U pa e arsyeshme ngritja e një strulture të re në KKRT, me specialistë të fushës si estetë, sociologë, gjuhëtarë, kritikë të artit, apo edhe psikologë, kineastë, personalitete të njohura të këtyre fushave.
Veprimtaria e këtij organizmi do të rregullohet me akte të brendëshme të institucionit. Vendimmarrja për problemet etiko morale të programeve të transmetuara do të jetë dallimi kryesor me statusin këshillimor të Këshillit të Ankesave.

## *E. BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARE*

Departamenti Ekonomik e ka mbështetur punën e tij në zbatim të ligjit nr. 8410 datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë " dhe dispozitat e tjera ligjore ne fushën ekonomike dhe të financave.

Buxheti dhe realizimi i treguesve financiare

Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit me vendimin nr. 320 date 28.01.2005, "Mbi miratimin e planit financiar te vitit 2006", miratoi treguesit financiare për vitin 2006, të ardhurat e shpenzimet:

| | Në milion lekë |
|---|---|
| ▪ Të` Ardhura | 66.1 |
| ▪ Përdorim të ardhura nga gjendja | 5 |
| ▪ Shpenzime | 71.1 |

### *i. Realizimi i të ardhurave*

Për vitin 2006 të ardhurat e institucionit tonë janë parashikuar të realizohen në masen prej 66.1 leke, jane realizuar 59.88 milion lekë me një mosrealizim në shumë absolute prej 6.2 milion leke , në përqindje 90.6

Realizimi i te ardhurave sipas struktures paraqitet si me poshte :

Ne milion leke

| Nr | Emrtimi | Plan | Realizim | Dif | % |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Të ardhura nga pagesa vjetore e liçensës dhe pagesa për marrjen** | **44** | **38.9** | **5.1** | **88.6** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **e liçensës, viti 2006** | | | | |
| **2** | **Të ardhura nga pagesa vjetore e liçensës diferencë nga viti 2005** | **19.8** | **17.8** | **- 2** | **89** |
| 3 | **Të ardhura nga pagesa për përpunimin e dokumentave të liçensës** | **0.5** | **1** | **+ 0.5** | **200** |
| 4 | **Të ardhura nga agjenti tatimor** | **0.5** | **0.75** | **+ 0.25** | **150** |
| 5 | **Të ardhura nga interesa bankare** | **1.2** | **1.4** | **+ 0.2** | **116** |
| 6 | **Të ardhura të tjera** | **0.1** | **0.03** | **- 0.07** | **30** |
| | Gjithsej | 66.1 | 59.88 | - 6.2 | 90.6 |

Pagesat vjetore të liçensave për vitin 2006

